

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 174, Prill 2018
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Prof. KOLË PRELA, METEOR QË VAZHDON 2 TË SHKELQEJË

Libri "Profesor Kolë Prela, Deputeti Historik i Dukagjinit", që është botuar para pak kohe, është një punë mjaft e mirë e studiuesit të kujdesshëm Prelë Milani. Ky shumë herë na ka mbledhur për të përruar libra të tij me tematikë të ndryshme, që nga humori e satira e këndshme por edhe therëse, studime të gjera, monografi të thelluara, publikime interesante e komente të guximshme. Në librin që kemi në dorë i bëhet një studim i thelluar dhe mjaft i gjerë deputetit historik të Dukagjinit Kolë Prela. Me dhe për cilësitë e tij, Kolë Prela, vërtetë e meriton të quhet "Deputeti Historik i Dukagjinit" sepse beri atë që nuk e ka bërë asnjë deputet dukagjinasi, që natyrisht i kemi pasur të paktë, dhe kjo jo për mungesë të mundësisë intelektuale dhe politike, por për vlerësime subjektive e nga larg.



MONOGRAFIA "PROF. KOLË PRELA - DEPUTETI HISTORIK I DUKAGJINIT" DHE AUTORI I SAJ PRELË MILANI 6

Kur merr e shkruan për trevën e gjerë malore të Dukagjinit, për ata malësorë epikë që janë bërë historikisht mburojë jo vetëm e vendlindjes së tyre, por edhe gjithë hapësirës veriore e mbarë Shqipërisë, mendja të shkon tek heronjtë që u bënë shkëmbinj tëpatundur qëndrese, si Mehmet Shpendi e qindra të tjerë...

Zadrimea: Vendlindja ime

*"Kurse Atdheu ynë është qielli, nga presim se vjen
si Shëlbues Jezu Krishti Zot". (Fil. 3, 20)*

Disa të dhëna të përgjithshme

Zona e Zadrimës shtrihet në veri të qytetit të Lezhës dhe, sipas historianëve, fillon tek ura "Plak Gjon" poshtë fshatit Mërqj dhe shkon deri në malin e Zadejës.

Sidoqoftë, kufiri verior nuk duhet të jetë kështu, sepse edhe në veri të Vaut të Dejës kemi fshatra deri në Rrenc, si: Spatharin, Ganjollën, Gurin e Zi, Jubanin e të tjerë, që kanë të njëjtat veshje e zakone me Zadrimën.

8 NDAHET NGA JETA PROFESOR MAHIR HOTI

Pak ditë më parë është ndarë nga jeta Profesor Mahir Hoti, ish Rektor i Ubniversitetit të Shkdrës "Luigj Gurakuqi". Sëmundja e pamëshirshme e mori në kohën kur familja, dhe shoqëria kishin shumë nevojë për të, por jeta kështu e ka.

Mahir Hoti u lind në një familje Shkodrane, më 15.1.1948. Ka përfunduar studimet në Univeristetin e Tiranës në vitin 1970. Në vitin 1999, fiton titullin "Profesor Doktor".



9 Një kafe me Antonin...

Të nderuar të pranishëm, zonja dhe zotërinj, familjarë dhe të afërm të gjakut, shokë dhe miq të Anton Grishajt në nderim të të cilit sot po përcjellim "këtë Kafe me Antonin...!" Në emër të Shoqatës së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Malësisë së Madhe", po aq edhe të familjes Grishaj, dua t'u shpreh gjithë mirënjohjen për pjesëmarrjen tuaj në këtë ditë të veçantë, ndryshe të një bashkëpunimi të llojit të vet mes nesh si institucion i krijuesve malësorë dhe familjes Grishaj, ndryshe në Përkujtimoren e organizuar në njëvjetorin e ndarjes fizike nga jeta të shkrimtarit, kineastit dhe publicistit z. Anton Grishaj."

MANIFESTIMI TRADICIONAL "ZËRI I VËLLAZËRISË - 2018", ME RASTIN E "VITIT MBARËKOMBËTAR TË 3 GJERGJ KASTRIOTI"...

Në kuadër të 550 vjetorit të vdekjes së heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti, të cilësuar nga strukturat qeverisëse si "Viti Mbarëkombëtar i heroit", me datë 6 - 10 Prill 2018 u zhvillua manifestimi tradicional "Zëri i vëllazërisë - 2018".



Prof. KOLË PRELA, METEOR QË VAZHDON TË SHKELQEJË

- kujtesë -

Libri “Profesor Kolë Prela, Deputeti Historik i Dukagjinit”, që është botuar para pak kohe, është një punë mjaft e mirë e studiuesit të kujdesshëm Prelë Milani. Ky shumë herë na ka mbledhur për të përruar libra të tij me tematikë të ndryshme, që nga humori e satira e këndshme por edhe therëse, studime të gjera, monografi të thelluara, publikime interesante e komente të guximshme. Në librin që kemi në dorë i bëhet një studim i thelluar dhe mjaft i gjerë deputetit historik të Dukagjinit Kolë Prela. Me dhe për cilësitë e tij, Kolë Prela, vërtetë e meriton të quhet “Deputeti Historik i Dukagjinit” sepse beri atë që nuk e ka bërë asnjë deputet dukagjinasi, që natyrisht i kemi pasur të paktë, dhe kjo jo për mungesë të mundësisë intelektuale dhe politike, por për vlerësime subjektive e nga larg.

Edhe në këtë libër, me kujdes dhe guximshëm Prelë Milani, nuk mund të qëndrojë spektator i publikimeve të pathelluara dhe të pasakta për krahinë e Dukagjinit, veçanërisht në periudhën e luftës Nacional-Çlirimtare, duke minimizuar apo mosvlerësuar pjesëmarrjen dhe veprimtarinë patriotike në këtë krahinë kundër pushtuesve të çfardo ngjyre.

Ky libër është shkruar me mjaftë pasion, me referenca, me kujtime të bashkëkohësve, me krahasime, pra është një monografi e thellë për Profesor Kolë Prelën.

Më shumë se për librin, veçanërisht sot, kam dëshirë për të folur e vlerësuar Profesorin Kolë Prela, për punën dhe veprimtarinë gjatë jetës së tij të shkurtër, sepse sot mbushen 70 vjet e 10 ditë nga koha kur u nda nga kjo jetë, ose më e plotë është te themi se e ndanë nga kjo jetë, në mënyrë tragjike dhe të pamerituar. Natyrisht që unë nuk e kam pasur mundësinë që ta njoh, sepse kur atë e dërguan në botën tjetër isha vetëm 6 ditësh, por kam dëgjuar të flitet për të. Po, kam dëgjuar të flitet në dy forma. Kam dëgjuar të flitet duke e treguar si një armik dhe tradhëtar i atdheut. Ata që flisnin në këtë mënyrë ishin të pushtetshmit e kohës, ose pranë tyre dhe që ishin të indoktrinuar aq sa as vetë nuk e kuptonin se çfarë ishte e vertetë dhe çfarë gënjeshtër. Forma tjetër e të folurit për Kolë Prelën ishte më e heshtur, flisnin nën zë, shikonin anash se mos dëgjoheshin nga “ata”, por flisnin me pasion, e vlerësonin dhe e ngrinin lart sa kishin mundësi për kohën, por mbase nuk e bënin gjumin rehat kur flisnin mirë për të. Në vitet nëntëdhjetë e në vazhdim u krijuan mundësitë që të flitet lirshëm. Ka shumë të drejtë Afrim Krasniqi kur thotë: “Sot kur është koha dhe mundësia për të folur atë çfarë mendon, do të qe mirë që të flitej më shumë për Profesorin e ndëruar Kolë Prela. Sot mund dhe duhej të ishte më i përjetësuar emri dhe vepra e tij, të dëshmohej pendesë, respekt dhe reflektim,

duke nderuar me meritën dhe dinjitetin e duhur trashëgimin politike, shkencore, dhe intelektuale të Kolë Prelës”. Po duhet folur, por edhe duhet vepruar më shumë për Kolë Prelën, të kujtohet, të përjetësohet me vlerësime, sepse jetën nuk mund ti kthehet më, por vlerësimet, fjalën e mirë, respektin e kujtesën ja kemi borxh. Fjala vjen, ishte e mundur që shkolla e re në Lagjen Mark Lula të mbante emrin e Profesorit Kolë Prela, e jo për të ruajtur ekujlibrat midis ne shqiptarëve, e qetësuar emocionet tona, të importojë një emër nga Anglia, sado që ajo ishte një grua dashamirëse për Shqipërinë dhe shqiptarët, ndonëse propozimi për emrin e Kolë Prelës ishte bërë zyrtarisht shumë kohë më parë se të ndodhte emërtimi zyrtar i saj.

Po perifraroj pak fjalë të disa figurave me shumë vlerë të cilët kanë vlerësuar Kolë Prelën:

At Daniel Gjeçaj shkruan: “Prof. Kolë Prela e pa shqipërinë të okupuar dhe luftoj si patriot për çlirimin e saj. Pa edhe inatin, mërinë, përçarjet dhe armiqtë midis shqiptarëve e për këtë i kulloj zemra gjak dhe për këtë kërkonte që të shtrinte dorën e bashkimit për një kulturë të shëndetshme, për qytetrim të vërtetë, për liri dhe demokraci, për të cilat dhe u flijua burrisht”.

“Kolë Prela qe një pishtarë drite, në punë mendje ndritur dhe me shikim të largpamës për të ardhmen.” Do të shkruante ish nxënësi i tij Prof. Shefik Osmani.

“Ai shkoj në amshim pa një njollë, me një pastërti shpirtërore që e arrijën vetëm zemrat e hapura para vetes dhe para krijuesit”, thotë Sami Repishti.

“Kolë Prela ka vendin e meritur në historinë antifashiste të Shkodrës dhe pluralizmit shqiptar”. Shkruante Qazim Kapisyzi.

“Prof. Kolë Prela bertiti, uluriti kundër bastisjeve, përndjekjeve, arrestimeve pa baza të njerzëve që mendonin “ndryshe” qofshin këta intelektual apo klerikë. Profesor Kola mbrojti Dukagjinitin e tij, dukagjinitin tonë, e duke mbrojtur Dukagjinitin mbronte gjithë Shqipërinë. U ngrit kundër padrejtësisë dhe mbrojti “fajtorët e pa faj”, ashtu siç dinte ai, jo me llafe boshe e vend e pa vend, por në organin më të lartë ligjevënës, na Parlamentin shqiptar. Për këto edhe e pësoj që i kushtoj jetën” thotë Fadil Kraja.

Vlerësime të tilla për Prof. Kolë Prelën mund të rreshtojmë shumë e shumë, sepse e tillë ishte jeta e tij, ishte plotë energji, plotë bëma në shërbim të Atdheut, ishte

i palodhur në shërbim të çlirimit dhe përparimit të vendit.

Kolë Prela u lind më 19 tetor 1916 në familjen e Prelë Gjokës në Pepsujmaj të Shoshit. Familja e tij largohet nga



Pepsujmajt në vitin 1922, kur Kola ishte vetëm 6 vjeç, natyrisht për një jetë më të mirë. Prelë Gjoka u dha edukatë shumë të mirë djemëve të tij. Mbi të gjitha u ushqeu dashurinë për vendlindjen e tyre dhe për Shqipërinë në tërësi, dhe kjo do të ishte ajo që nxiti Kolë Prelën të ishte një pjesëmarrës dhe drejtues me potencial të madh në përhapjen e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare. Ai qe një luftëtar i vendosur për çlirimin e Shqipërisë. Ishte i treti në listën e këshillit nacional-çlirimtar të qarkut të Shkodrës më 12 tetor 1943, pas Sabri Gjonit dhe Riza Danit. Po kështu edhe në shtabin e forcave të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare për Shkodrën pas Sadik Bektshit dhe Qazim Kapisyzi. Kolë Prela ishte antifashist i vendosur. Kolë Prela shpejt do të kuptonte se çfarë përfaqësonte dhe kush ishte qëllimi i fashizmit pushtimi fashist i Shqipërisë 79 vjet më parë. Pushtuesit fashistë trumbetuan se erdhën si miq, por çfarë miku është ai që vjen

me anije luftarake, avion, tanke, ushtarë dhe zënë të katër portet dhe qiellin e shqipërisë në orën 4 të mëngjesit. Sado e vogël ishte rezistenca në Durrës apo porte të tjera, tregoj se fashizmi nuk ishte i mirëpritur. Kolë Prela do të luftonte kundër pushtuesve fashist me gjithë forcën e tij, por do të pushkatohej 9 vjet pas pushtimit fashist të Shqipërisë e kur Shqipëria ishte çliruar, e lufta kishte kohë që kishte mbaruar. Ata që ja ndërprejnë jetën ishin bashkëatdhetarët e tij por që kishin mendime të kundërta.

Prof. Kola ishte një intelektual i mirëfilltë. Ai ishte më shumë se mik i librit, ai ishte skllav i librit. Ai mendonte se është puna dhe përpjekja për të ecur përpara. Ishte drejtori i Shkollës Normale në Elbasan, e cila do të përgatiste një plejadë të tërë mësuesësh, për ti dhënë dritë e dituri brezit të ri.

Ai donte me gjithë forcën e shpirtit të tij lirinë dhe përparimin e vendit.

Ai donte gjithëpërfshirjen pas çlirimit. Ai fliste hapur dhe pa dorashka për gjithëpërfshirje në jetën politike shoqërore të vendit. Kolë Prela kishte papajtueshmëri politike dhe ideologjike me regjimin që u vendos, ishte kundërshtar i vendosur i monizmit, por kjo i kushtoj jetën. Pushkatohet me 29 mars 1948. Çdo kush mund të rrëzohet, por lumturi është për atë që ringritet. Ringrihen ata që e meritojnë. Dhe Kolë Prela u ringritë për vlerat dhe meritat e tij të pavdekshme.

Është shumë e rëndësishme të thuhet se në gjithë jetën e tij prej 32 vjet e gati 7 muaj, në të gjithë veprimtarinë e tij politiko shoqërore të kohës, në të gjithë marrëdhëniet dhe lidhjet politike, shoqërore dhe ushtarake, ka qenë shumë i kujdesshëm që për asnjë moment populli i krahinës së Dukagjinit, por edhe ai shqiptar, të mos ja shihte sherrin punës dhe veprimtarisë së Kolë Prelës, siç mund të ketë ndodhur ndonjë rast tjetër, por përkundrazi ai qe njeri paqësor, për të ndarë sherre, për të penguar reprezalje, vrasje, djegie, spastrime e persekutime. Ai nuk lejonte dhe nuk mund të lejonte, që populli i tij të vuante për gabime të tij. Ai ishte trim, i vendosur, por gjithmonë njeri i kulturuar, intelektual i mirë, fjalë ëmbël dhe i vendosur në ato që shprehte.

Emri i Kolë Prelës i bën nder Dukagjinit, Shkodrës dhe gjithë Shqipërisë. Kolë Prela është një meteor që vazhdon të shkëlqejë.

MANIFESTIMI TRADICIONAL “ZËRI I VËLLAZËRISË - 2018”, ME RASTIN E “VITIT MBARËKOMBËTAR TË GJERGJ KASTRIOTI” ..

Në kuadër të 550 vjetorit të vdekjes së heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti, të cilësuar nga strukturat qeverisëse si “Viti Mbarëkombëtar i heroit”, me datë 6 - 10 Prill 2018 u zhvillua manifestimi tradicional “Zëri i vëllazërisë - 2018”.

Çmime nderi, kënge, muzikë, valle, mikpritje me zemër të bardhë, pikërisht ashtu siç i ka hije Shqiptarit, ishte ajo çfarë na shoqëroi në këtë manifestim. Prezantimi dhe përfaqësia e pjesëmarrësve ishte dinjitoze nga shoqatat pjesëmarrëse, përmendim këtu: Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, Shoqatën “Martin Dreshaj”, shoqatë “Malësia e Madhe-Nderi i Kombit”, shoqata “Sali Mani”, shoqata “Iliria” e Tuzit e shoqata të tjera në Kosovë, që nga Presheva dhe Istogu, ansambli “Rugova dhe mjaft të tjera.

Manifestimi i pati fillesat e tij me datën 6 Prill, në Lezhë, pranë Memorialit të varrit të Gjergj Kastriotit që ishte edhe arsyeja që na mblodhi në këtë rast feste. Patëm një mikpritje të ngrohtë nga N/ Kryetarja e Bashkisë, zonja Alfrida Marku dhe drejtori i kulturës për Qarkun e Lezhës zoti Paulin Zefi dhe të pranishme të gjitha organizatat e lartpërmendura pjesëmarrëse.

Pasi nderuam varrin e Gjergj Kastrioti me kurorë e me lule, patëm përshëndetjen e mirëseardhjes nga N/ kryetarja e bashkisë. U mbajtën fjalime përshëndetëse edhe nga Sekretari i Shoqatës “Martin Dreshaj”, Frasher Racaj, Kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Ndue Sanaj, i cili me këtë rast dha dy tituj nderi “100 vjet arsim e kulture në Dukagjin”, për Zojë Mustafën (Guri) dhe Gjergj Guri, pas vdekjes, me motivacion “Njohës dhe promovues i vlerave më të spikatura të folklorit dhe kulturës tradicional dukagjinase; kontribuues në ruajtjen dhe përcjelljen brezave kulturën tradicionale të folklorit popullor dukagjinase”, që ju dorëzuan përfaqësuesit të brezit pasardhës dhe shumë krenar për arritjet e pasardhësve të tyre, Nikolin Guri.

Veprimtaria do t'i linte vendin në këngëve dhe valleve tipike folklorike. Në veçanti nga Ansambli “Rugova” me një performancë të shkëlqyer të “Valles së Shpatave”, këngë trimërie Ismet Dema, e ndërsa shoqata “Atdhetare Dukagjini” u prezantua nga Gjovalin Shani, me këngën “Gjergj Kastriotit e Nene Terezës” si dhe nga Pëllumb Vatnikaj, me këngën “Kosova - Trimja po çon fjalë” si për t'i unifikuar këto dy krahina të Shqipërisë. Një kujdes i veçantë u bë dhe nga Mirash Ftoni, kryetari i degës së shoqatës në Lezhë, i cili kishte marrë masa për të qene prezent dukagjinase në Lezhë, në këtë veprimtari, që në mes tyre ishte Dede Marashi, Fran Marku, Ndue Ziçi, Nikolin Guri e të tjerë, të cilin e falënderojmë dhe ju jemi mirënjohës për prezencën e tyre në këtë veprimtari për vazhdimësinë e vlerave që Dukagjini ka.

Pas veprimtarisë në Lezhë, veprimtaria do të zhvendoset në Hot, ku me rastin e 107 vjetorit të nisjes së Kryengritjes së Malësisë kundër pushtuesit në shekuj të atij osman dhe ngritjes së Flamurit të Gjergj Kastriotit në malin e Deçiqit, u organizua një ceremoni përkujtimore nga Bashkia e Malësisë së Madhe, dhe të pranishme të gjitha organizatat pjesëmarrëse në këtë Manifestim. U

zhvillua veprimtaria me muzikë, valle dhe fjalë përshëndetëse, ndër të tjera Shoqata “Atdhetare Dukagjini” duke u treguar e kujdesshme dhe për të nderuar siç duhet veprimtarinë, që pasi dha fjalën përshëndetëse, i dha titull nderi për: “100 vjet arsim e kulture në Dukagjini”, për Dode Kaçen, me motivacion: “Për devocion e përkushtim të përhershëm në fushën e arsimit dhe ngritjes së nivelit

kulturor të bashkësisë dukagjinase”. Në këtë veprimtari u prezantua dhe me këngëtarin Pëllumb Vatnikaj, anëtar i Shoqatës.

Siparin e vazhdimësisë së veprimtarisë, me datën 7 Prill e nisim në mjediset e bibliotekës së universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, ku do të zhvillohej edhe ceremonia e prezantimit të monografisë, me titull “Profesor Kolë Prele, deputeti historik i Dukagjinit”, të autorit Prele Milani. Të pranishëm në ceremoni ishin nga të gjitha hapësirat e Shqipërisë së Veriut dhe më gjerë nga Peja, Deçani e deri në Skenderaj, nga ansambli “Rugova”, nga Malësia e Madhe, nga hapësirat e Dukagjinit si dhe familjare e të afërm të autorit dhe të profesor Kole Preles. Të pranishëm nga strukturat administrative ishte edhe Sekretarja e Prefekturës së Qarkut Shkodër, zj. Felek Kasemi, e cila në emër të Ministrisë së Mbrojtjes dorëzoi titullin e nderit “Çertifikatë mirënjohjeje”, për profesor Kolë Prelen, pas vdekjes, për pjesëmarrjen e tij në Luftën Nacional-Çlirimtare”.

Një nderim i merituar me titull “Mirënjohja Martin Camaj”, iu bë edhe autorit të librit, Prele Milanit, titull i cili iu dha nga Shoqata “Atdhetare Dukagjini” me motivacionin; “Për kontribute të shquara intelektuale në fushën e studimeve dhe pasqyrimeve themelore të vlerave përfaqësuese multikulturale e historike të Dukagjinit në përgjithësi dhe figurave të tij në veçanti. Gjithashtu, për një kontribut të veçantë në fushën e arsimit dhe në realizmin e misionit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”. Një koktej me biseda të këndshme mbi librin dhe jo vetëm u zhvillua nga Familja Shpatina. Pas kësaj ceremonie, Shoqata organizoi te një drekë mikpritëse për miqtë e ardhur nga Kosova.

Ditën e Hënë, të datës 9 Prill, është momenti të vijojmë programin e këtij Manifestimi të miqtë tanë në Kosovë”, që në orën 7 e 30 të mëngjesit u bë nisja për në komunën e Deçanit.

Vizita filloi me fjalët përshëndetëse të kryetarit të komunës dhe përfaqësuesve të organizatave.

Me pas u bene homazhe duke nderuar dhe duke vendosur lule në varrezat e dëshmorëve, në Glllogjan. Një koncert festiv me kënge, muzikë dhe valle u mbajt rreth orës 15 në oborrin e Komunës. Në fjalët përshëndetëse të të ftuarve, në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, mbajti fjalën, sekretari i saj, z. Luigj Shyti dhe së bashku me Prele Shytanin, e Tringa Rapi, ndanë dy tituj nderi “Mehmet Shpendi”, për Tahir Selim Geci, mbete në luftë në vitin 1913, me motivacion: “Për heroizëm të pasqyruar në mbrojtje të Atdheut. U përball me çdo lloj pushtuesi duke treguar ndërgjegjen e vetëdijën e larte kombëtare, në emër të secilës u flijua për të mbetur i përjetshëm në kujtesën e



brezave”, dhe për Lan Selim Geci, renë në luftë, në vitin 1943, me motivacion: “Përfaqësues tipik i heroit sublim me ideale të larta kombëtare. I lartësuar në piedestalin e heronjve, që me gjakun e tij ushqeu tokën amë, për të mbetur përjetësisht bir i pavdekshëm i saj”

Një nderim te veçante dhe përshëndetje speciale për të ftuarit ishte nga Gjon Kosteri, i cili na nderoi duke kënduar këngë maja krahut dhe një këngë për Gjergj Kastriotin, që siç e përmendëm është arsyeja e mbledhjes tonë së bashku, performanca u shoqërua edhe nga katër anëtarët e tjerë pjesëmarrës nga shoqata, të cilët ishin të pranishëm me veshje tradicionale, çka e bëri më të bukur dhe domethënëse paraqitjen.

Në fund të koncertit për të nderuar pjesëmarrjen e Shoqatës Atdhetare Dukagjini, asaj iu dha titull nderi “Mirënjohje”, për pjesëmarrjen në këtë Manifestim, dhe motivacioni i saj ishte: “Së bashku drejt bashkimit kombëtar”.

Pas koncertit pjesëmarrësve iu ofrua një darke nga kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, në një zonë turistike jashtë qytetit. Darka kaloi shumë e këndshme, me një atmosfere festive, me këngë, valle nga të pranishmit, deri në orët e vona të natës.

Data 10 Prill, shënon edhe ditën e fundit të këtij manifestimi, dhe një nga momentet kulmore të veprimtarive tona, pas mëngjesit u nisem në Prekazin historik, në familjen e Jasharajve. Një mikpritje nderi na u rezervua nga drejtori i kulturës për komunën e Skenderaj, z. Ramiz Shala. Bëme homazhe duke nderuar dhe vendosur lule gjithashtu në varrezat e pjesëtarëve të kësaj familjeje, ku pothuajse e gjitha ra në luftë për çlirimin e Kosovës, në krye të kësaj ishte Adem Jashari.

Pas homazheve patëm një mikpritje me zemër të bardhë, nga përfaqësuesi i kësaj familjeje z. Rifat Jashari, ku biseduam si midis vëllezërve. Pas takimit gjetëm pak momente te bënim fotografi me z. Jashari duke ditur vlerat e patjetërsueshme dhe kontributin e rëndësishme që kjo familje ka dhënë për shpalljen e Kosovës shtet të lire.

Për koncertin përmbyllë u zhvendosëm në sheshin “Adem Jashari”, para monumentit të tij madhështor të ngritur në këtë shesh. Koncerti përmbyllës u organizua nga drejtoria e kulturës së Komunës Skenderaj, me të pranishëm të shumtë të shoqatave dhe organizatave pjesëmarrëse. Një nga performancat më të arritura është gjatë vizitës u bë nga djemtë dhe vajzat e shoqërisë “Iliria” në Tuz dhe grupi i valleve të Drenicës duke kombinuar në performancën e tyre valle të zonave dhe krahinave të tyre, por edhe më gjerë. Moment shumë emocional dhe domethënës ishte kur kërcyen vallen e “Besës së T’ Lekve” si për të shtuar dashurinë për atdheun. Performance e veçante ishte kënga maja krahut kushtuar për nder të Adem Jasharit, kënduar nga Gjon Kosteri.

Fjalë përshëndetëse u mbajtën sigurisht edhe në këtë koncert të bukur mbyllës, ku edhe në mbajtëm fjalën tonë duke dorëzuar titullin e nderit “Mehmet Shpendi” për luftëtarin e bashkëluftëtarin e Azem Galices, Shaban Mangjollit,



me motivacionin: “Për heroizmin e lartë si një nder luftëtarët e paepur dhe bashkëluftëtarit i Azem Galicës, që tërë jetën luftoi pa kursyer as gjakun për çlirimin dhe bashkimin e Shqipërisë, për të mbetur i pavdekshëm”.

Komuna Skenderaj pas koncertit na ofron një drekë përmbyllëse, edhe këtu

nuk kishin si të mungonin performancat me çifteli dhe këngë kushtuar heronjve tanë. Pas drekës është momenti për t’u nisur në Shkodër.

Mund të nxjerrim disa përfundime, por një është më e veçanta, jo vetëm për ne, por dhe për miqtë tanë, se si dhe here të tjera, dhe këtë radhe pame

bashkëpunimin e mirë, të shkëlqyer të Shoqatës së Vëllazërisë Kosove-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj”, me strukturat drejtuese të komunave, në veçanti të Rrafshit të Dukagjinit, të cilën ne, e kemi për mos thënë aspak, shume dobëte, si me ato të Njësisë Administrative të zonës së Dukagjinit, po ashtu dhe me ato Bashkisë Shkodër, që ato, por sigurisht ne, duhet të shohim më mirë komunikimin me këto struktura vendore, në mjedisin e të cilave zhvillon veprimtaritë Shoqata Atdhetare “Dukagjini”.

Në fund të këtij reportazhi një falënderim shumë i veçantë është për ata që bënë të mundur pjesëmarrjen tonë në manifestimin “Zëri i Vëllazërisë-2018”, të cilët janë Ndue Ftoni, me banim në Miçigan, Preke Nike Gjonaj, me banim në Kanada, Gjergj Leqejza, Prele Milani e Mikel Shpatina, si dhe zonja File Sstrugaçi për mundësimin e veshjeve tradicionale. të cilët i falënderojmë dhe i urojme me shprehjen popullore “Paçin e dhënçin!”.

Me dëshirën e mirë për t’ju ofruar disa momente të bukura nga pjesëmarrja e jonë në këtë Manifestim, përcollëm këtë reportazh për lexuesit e gazetës “Dukagjini”.

Klodiana Serraj

PËRSHËNDETJE NË KOSOVË

Përshtëndetje dhe mirëse ju gjejmë vëllezër të një gjaku, gjuhë, toke dhe kombi!

U bë një kohë që kemi një bashkëpunim shumë të mirë, luajal, mirëkuptues, dashamirës por dhe rezultativ.

Në të gjithë punën tonë, në të gjithë veprimtaritë, diskutimet, promovimet, analizat, kemi pasur mirëkuptim në shkallën më të lartë, më zemër të hapur, pa droje pa mëdyshje.

Kemi zhvilluar një seri veprimtarishë në të gjithë territorin ku veprojnë shoqata tona në Rafshin e Dukagjinit, në Kosovë, në Shkodër e Shqipëri, në Malësi të Madhe, në Lezhë, në Rozhajë e Tuz, të

cilat i kanë shërbyer bashkëpunimit, gjuhës, historisë dhe kulturës tonë të përbashkët, kanë rritur ndjenjen e atdhedashurisë mbarë shqiptare.

Me punën tonë të vëmendshme por dhe të thelluar në pikpamjen intelektuale dhe shkencore kemi vënë dhe po vëmë gurë të çmuar në murin e ndërtesës së njëjtësimi të kombit shqiptarë, të ndarë nga të tjerët dhe për interesa të tyre, e asnjëherë në interes të shqiptarëve.

Kur punon dhe len gjurmë pozitive është vepër shumë e madhe, shumë e rëndësishme. Në bashkëpunim me njëra tjetrën, por dhe veç e veç ja kemi arritur këtë qëllimit. Është arritur një përvojë

e pasur dhe janë krijuar kapacitete intelektuale shoqërore që premtojnë thellim të bashkëveprimi, me më shumë veprimtari, më shumë larmi, më shumë studime e diskutime të përbashkëta, më shumë punë konkrete, më shumë afrim e bashkëpunim. Një rol me rëndësi ka luajtur edhe gazeta "DUKAGJINI" si një lajmëtare dhe propaganduese e veprimtarive tonë të përbashkëta. Edhe në të ardhmen, kjo gazetë, do të vazhdojë këtë qëndrim dhe publikim, sepse do të ndihmojë për sot por edhe brezat që vinë do të gjejnë në të se si bashkëpunuan paraardhësit e tyre në trojet mbarë shqiptare.

Të respektuar të pranishëm!

Vllazën dhe motra!

Kohët që po kalojmë janë shumë

interesante, dhe vështirë të parashikueshme. Globalizimi po shfaqet vullshëm. Sot përhapet informacioni shumë shpejt, i çfardo natyre qoftë. Edhe ne duhet të na gjejmë të përgatitur, më të përgatitur, por kryesorja është ti afrohem njëri tjetrit, identitetit tonë ardhur dhe formuar në shekuj, kulturës tonë të vyer, historisë tonë të lashtë, gjuhës tonë mirë, gjakut tonë të pastër, dashurisë tonë njerzore, të sinqertë e të pashtershme.

Shekulli i 21-t deshiroj dhe besoj se do të jenë shekulli i shqiptarëve në Gadishullin Ilirik. Uroj që të bëhet realitet dhe sa më parë. Përshtëndetje dhe faleminderit për mikpritjen!

*Luigj Shyti
Deçan, 9.4.2018*



Një takim i veçantë për rrugën e Dukagjinit

Në bar-restorant "Tradita", me nisem e shqiptaro (dukagjinasi) –amerikanit, Ndue Ftoni dhe Gjon Dugiles, pronari i këtij biznesi dhe kryetari i grupit drejtues të Lëvizjes për Rrugën e Dukagjinit, me datën 15 prill 2018, u bë një takim i veçantë për rrugën e Dukagjinit.

Ky takim ishte i veçantë, se ishin prezent personalitetet e kulturës dhe artit, artistet e Shkodrës, si Mjeshtri i Madh dhe Anëtari i Nderit të Shoqatës Atdhëtare "Dukagjini", shkrimtari Fadil Kraja, drejtoresha e Teatrit "Migjeni", Mjeshtria

Rita Gjeka, Mjeshtri Bujar Qamili, këngëtar i madh i kombit tone, humoristi Gëzim Kruja e Besnik Çinari, aktorja e teatrit "Migjeni" zonja Merita Smaja, Drendë Xhaj, dhe Rajmonda Marku, Astrit Fani e të tjerë e të tjerë.

Ky takim tregojë, se shqetësimi i dukagjinase për rrugën e tyre, ishte dhe është shqetësim i të gjithëve, çka tregon se ne, në Lëvizjen tone nuk jemi vetëm, kemi mbështetjen e mbare të qytetarëve të Shkodrës, me në krye personalitetet e artit e të kulturës të saj.

Ishte një takim shume emocionues, kur këta personalitete jo vetëm që shprehen mbështetjen e tyre ndaj kësaj Lëvizje të ligjëshme të dukagjiansve, por në veçanti kur humoristi, Mjeshtri i Madh Besnik Çinari, në emër të gjithë këtyre personalitetëve të kulturës e artit të Shkodrës i dorëzuan kryetarit të kësaj Lëvizjeje, zotit Gjon Dugilaj kontributin e tyre financiar. Këta u uruan me shprehjen popullore "Paçin faqen e bardhe! Paçin e dhënçin!"

Nga ky takim doli thirrja e ligjëshme për mbare dukagjiansit kudo janë të

bëhen pjese e kësaj lëvizjeje me kontributin e tyre modest, se sa më shumë të përfsihien në këtë lëvizjeje, aq më i madh do të jetë shqetësimi ndaj qeverisë, marrja e përgjegjësisë së saj për t'iu fut punës për rindërtimin e rrugës së Dukagjinit sa më shpejtë.

Pas këtij takimi, pjesëmarrëseve, zoti Ndue Ftoni ju shtroi drekte në Bar-Restorant "Tradita".

Redaksia



MONOGRAFIA “PROF. KOLË PRELA - DEPUTETI HISTORIK I DUKAGJINT” DHE AUTORI I SAJ PRELË MILANI

Ma. **Donatela Guri**

Mësuese e Gjuhë - Letërsisë
në shkollën “Don Bosco” –Shkodër

Hyrje

Kur merr e shkruan për trevën e gjerë malore të Dukagjinit, për ata malësorë epikë që janë bërë historikisht mburojë jo vetëm e vendlindjes së tyre, por edhe gjithë hapësirës veriore e mbarë Shqipërisë, mendja të shkon tek heronjtë që u bënë shkëmbinj tëpatundur qëndrese, si Mehmet Shpendi e qindra të tjerë, të cilët u vunë gjoksin sulmeve të turqve e serbëve, malazezëve dhe çdo hordhie që u munduan t’i mposhtin ata njerëz krenarë e të pathyeshëm, bij të paepur të lirisë dhe identitetit shqiptar. Kjo krahinë etnikisht e pastër për shekuj me radhë, me kushte jete e klime jo pak të vështira, duhet njohur edhe për tregues të tjerë, siç janë: dija, virtytet e larta morale, besa e mbajtur, mikpritja dhe mbrojtja e saj, e drejta e tjetrit, besimi dhe ritet, etnosi historik, veshja dhe ceremonitë e jetës, idioma gjuhësore aq e veçantë - të gjitha këto, së bashku, formojnë fizionominë shqiptare për të cilat janë shquar shquhen banorët e kësaj treve. Por Dukagjini ynë, në ditët tona, po njihet edhe për botën intelektuale të bijve të saj: për shkrimtarë e studiues, folkloristë e mbledhës të krijimtarisë popullore, profesorë universiteti, etnografë e këngëtarë, gjeografë e historianë dhe sportistë kampionë të mëdhenj. Pa u zgatur, do të na mjaftonin 3 emra të përmendur që e kanë parë diellin e Dukagjinit qysh në lindje, si: **At Bernardin Palaj**, nga Shllaku, poeti e përkthyesi, mbledhësi i Eposit të Kreshnikëve (gjerdani i Visareve të Kombit), që së bashku me birin tjetër të Asisit, Pater Donat Kurtin, për kulturën shqiptare, mund të quhen pa antonomazi: **Vëllezërit Grimm** të Shqipërisë, siç kanë qenë **Grimm**-ët e mëdhenj të kulturës gjermane të shek. XIX. Një tjetër bir i Shën Françeskut, që ndrit kujtesën tonë për këto male, është **Pater Jakob Marlekaj** – plançor, profesor i lingistikës në Universitetin më të vjetër të Botës – në Bolonjë e më vonë në Bari, i cili ka mbajtur atje, për aq vite, Katedrën e gjuhës shqipe, ka drejtuar e udhëhequr me dhjetëra e dhjetëra teza shkencore të doktorantëve na ka lënë një trashëgimi të pasur shkencore. Më i riu prej tyre, **At Daniel Gjeçaj**, thethjan, romanisti ynë më i njohur, shkrimtar e publicist, përkthyes e kulturolog, studiues dhe një nga fishtologët më të shquar: biograf dhe botues i veprës së Poetit tonë Kombëtar, në Itali.

Pa u zgatur me bij të tjerë intelektualë të Dukagjinit: poetë e publicistë, analistë dhe mendimtarë, do të shpreh pak fjalë për autorin e monografisë që kemi tani përpara, për Prelë Milanin, të cilin, Malësia dhe Shkodra, gjithë kultura shqiptare, e njeh si gazetar të formuar dhe publicist stili, poet të satirës së hollë, antolog të ditur, por prej 10 vjetësh e këndeje, ai po

shquhet si monograf i nivelit shkencor, me rreth 20 libra që ka botuar. Prelë Milani jo vetëm ka ndriçuar figura e personalitete të fushave të ndryshme të hapësirës së krahinës së Dukagjinit, por ka arritur të bëjë ridimensionin e tyre historik e shoqëror, t’i sjellë ata në fronin e lavdisë së tyre të merituar. Në serinë disa vëllimshme “**Dukagjini ynë**”, me bashkautor, publicistin e talentuar, Lazër Kodra, tërheqin çdo lexues biografite e thurura për Simon Dedën



e Vera Bregun, për Mirash Vuksanin e në mënyrë të veçantë për “magjistarin e koshit”, si e quan ai Mjeshttrin e paharruar të koshit, basketbollistin Renato Radoja. Këto e të tjera në radhën e pasqyrës së ndritshme të njerëzve të shquar të Dukagjinit, autori nuk i ka si prurje eseje, por janë aq të mbështetura, me kujtime, fakte e dokumente të cituara nga shtypi i kohës kur kanë vepruar sportistët që e kanë ngritur flamurin shqiptar brenda e jashtë Atdheut, si kampionë të mjaft fushave sportive. Shkrimtari e studiuesi P. Milani na çon në mendje autorë të trevave të tjera, si dr. Luigj Martinin dhe Gjon Markun, të cilët kanë nxjerrë në dritë veprat e shquara të mirditorëve, historinë e derës princërore të Kapedanëve, intelektualin e hollë të viseve të kësaj krahine që luftoi në shekuj deri në Krahinë Autonome, duke ruajtur përkatesitë e veta si organizëm social i veçantë në verilindje të vendit, pa harruar fizionominë shoqërore dhe transformimin e saj deri në globalizëm. Duhet nënvizuar ky fakt, sepse kultura dhe identiteti i gjithë trevave: me tradita e zakone, kanu e gjuhë, përbëjnë mbarë kulturën shqiptare.

Monografia për deputetin historik, prof. Kolë Prelën

Në radhën e shkrimtarisë së P. Milanit, duket se monografia për njërin prej njerëzve më të shquar të Dukagjinit, prof. Kolë Prelën, ka zgatur më tepër se vepra të tjera dhe ka pasur më shumë punë, pasi figura e deputetit historik, siç e quan autori, është vendosur në një periudhë jo të lehtë për t’u përshkruar, një periudhë jo vetëm e luftës për çlirim kombëtar,

kur mjaft idealistë, duke ëndërruar më së pari lirinë e vendit, si profesori i ri, Kolë Prela, që, pak vite i kthyer prej Europe, iu kushtua qëndresës luftarake për ideale të larta njerëzore, vuri të gjitha forcat për bashkimin e popullit në një front të vetëm kundër pushtuesve, pa ditur se ç’diktaturë do të sillte kauza e asaj kohe, që do ta çonte deri në flajm. A nuk do të ishte kështu edhe jeta e veprimi politik i Zef Malës, që u rreshtua si idealist ndër

Italia, në fillim, në Normalen e Elbasanit, më pas në Liceun Shtetëror të Shkodrës.

Në këtë paraqitje të shkurtër, do vënë në dukje, **më së pari**, se monografia merr vlerë të jashtëzakonshme, pasi autori ka kërkuar dhe ka arritur të sjellë me nota rrëfimi artistik mjedisin, ku lindi dhe u rrit që fëmijë Kolë Prela; si bashkëqytetar i asaj treve, autori njeh mirë e në thellësi familjen e tij, që e mëkoi me ndershmëri dhe drejtësi; lexuesi njeh mjedisin e shkollës ku u arsimua i riu Prela, si dhe qëllimin për të ndjekur studimet e larta, synim që ai e realizoi me aq sukses, duke u kthyer specialist në një gjimnaz me tradita të njohura pedagogjike e shkencore. Ngjitja e heroit me Lëvizjen Çlirimtare vjen si prirje e tij intelektuale dhe dëshirë e trashëguar, qëndrimi i palëkundur ndaj drejtësisë ishte përgatitje e formatit idealist evropian, kurse trajtimi, gjykimi dhe fundi i tij, erdhën sipas kodeve të diktatorëve të pushtetshëm, që po ngjisin shkallë të hierarkisë shtetërore në mënyrë drakoniane, sipas parimit të Mendozës “*qëllimi justifikon mjetin*.” Ka shkodoranë dhe familje shkodorane që i kujtojnë, jo veç vitet e rënda të asaj kohe, por edhe salvuesit e atyre gjyqeve, që i sjell autori nëpër vendimet me vdekje e procese hetuesie, kujtojnë qytetin e tyre me 13 burgje, ku dergjeshin e prisnin të dënoshin njerëz të pafajshëm!

Së dyti, çmojmë në këtë vepër monografike, gjuhën e zgjedhur, me karakterizime të personazheve, me ngjyresa të të folurës së njerëzve të thjeshtë, nga fshati e qyteti, dëshmitë e tyre dhënë me sinqeritet e drejtpërdrejt, aq të besueshëm, sa të krijohen tablo të gjalla të jetës plot pasoja tragjike, që kalonte sidomos Shkodra e viteve pas Luftës. **E treta**, Prelë Milani, në këtë biografi të profesorit – deputet të Dukagjinit, nuk është përqendruar vetëm tek formimi, ngritja dhe rënia tragjike e heroit, por lexuesi gjen në vepër skena të jetës ekonomike, shoqërore, politike, familjare dhe ideologjike të mbarë një populli, të mbarë qytetit të Shkodrës, që po kalonte ditë agonie të rënda: me gjyqe mizore, me dënime me vdekje, me luftën kundër besimeve fetare dhe praktikave të tyre nga klerikët; dyndje, internime dhe pushkatime në masë, ndaj të cilave deputeti i ri intelektual ngrinte me guxim zërin në mbrojtje të lirisë e së vërtetës, pa u trembur për fundin që e priste.

Së katërti, vepra monografike që kemi në dorë, si jetëshkrim dhe aktivitet i një individi dhe veprimtari e masës, është thurur mbi dokumente të cituara, duke shfrytëzuar Arkivat e Shtetit, shkresa e vendime të proceseve gjyqësore të firmosura nga hetues, gjykatës dhe prokurorë me emra konkretë, të bazuara në vepra të shkruara nga autorë vendës e të huaj; nuk janë lënë jashtë këtyre dëshmime as gazeta e buletine të kohës që kanë pasqyruar jetën ushtarake e politike të atyre viteve të errëta për mbarë një popull. Janë gjithsej, 252 citime fragmentesh, që lidhen me kërkimet e palodhshme të



Kur forcohet siguria ndërkombëtare, mitomanët flasin për siguri kombëtare



nga Bes Bektashi

SHBA-të dhe BE-ja përfundimisht, po vendosin kontrollin e tyre të plotë mbi dy sisteme të rëndësishme të shtyllave të shtetit shqiptar! Për herë të parë në mënyrë të qartë dhe deri në “arrogancë” politike, dy miqtë e lartë dhe të vetëm të rëndësishëm të Shqipërisë – SHBA-të dhe BE-ja po kontrollojnë Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Brendshme. Kanë problem të madh të vendosin kontroll mbi drejtësinë më gjerë, sepse është e gangrenizuar plotësisht, por ju mjafton kontrolli tashmë në krye dhe disi më poshtë në Prokurori dhe po ashtu në krye dhe disi më poshtë në Ministri! Këtë kontroll nuk e kanë politik, as nuk e kanë pro mazhorancës sot. Absolutisht jo! Ky kontroll është tashmë i qartë, se ka të bëjë me pazotësinë tonë (shoqërore dhe politike) të mbajmë dhe ndërtojmë demokraci dhe shtet ligjor! Të gjithë sistemet partiake përfshi dhe PS-në sigurisht me e përgjegjshmja në shtet formim – nuk kanë mundur të vendosin realisht shtetin ligjor në institucionet e sigurisë?! Por ndërkombëtarët dhe padyshim SHBA dhe BE kanë mundësinë e NATO-s dhe modeleve kontrollues me agjensitë e tyre të qarta kundër krimit, politikës kriminale dhe sundimtarëve kriminalë të cilësuar dhe padyshim të provuar në Shqipëri. Po sigurisht pa as më të voglin dyshim në të dy anët e politikës shqiptare pothuaj marrëzisht e inkriminuar.

Problemi është ky dhe nuk do të shkojë gjatë deri sa institucionet ndërkombëtare

të kontrollojnë realisht disa sisteme të shkatërruar demokracie në Shqipëri. Janë sigurisht mbas drejtësisë, por nuk ka kurrfarë dyshimi që me vendosjen e kontrollit mbi të – ekonomia, financa dhe pas tyre deri te kultura e arsimit të luhet tjetër uverturë. Nuk bëhet ndryshe te ne! Ky është momenti i fundit që si SHBA dhe BE mund të tolerojnë më. Bashibozukë të partishmërisë dhe jo modelit institucion demokratik, tashmë kanë problem të madh me pikërisht ndërkombëtarët dhe kontrollin e tyre në Shqipëri. E konsiderojnë “besim” ndaj socialistëve dhe Ramës dhe kjo është e vetmja leverdi e tyre politike që ka mbetur. Sajojnë mikun e huaj, që bashkohet me “armikun e tyre politik”. Fjalët e fundit të tyre dhe shkrimet fejbukiste janë një “mrekulli” inatçore dhe truharllëk që vijon prej kohësh. Personat të tillë që kanë qenë dhe ministra të Brendshëm, por dhe lartësi presidenciale, nuk ju mbetet asgjë tjetër përveç faktit të inatit politik që kalon masat dhe shprehet për rrezik në siguri kombëtare! Njerëzve që lejuan politikisht Lazaratin dhe po politikisht kanabisin jo vetëm atje, por dhe në malësi kur ishin ministra të brendshëm – tani kur fillon goditja e tonelatave si kokainë dhe kanabis, ju kujtohet “siguria kombëtare”. Në fakt harrojnë operacionet e kohës së tyre kudo në malësi të e Shqipërisë, por jo në Lazarat. Duke qenë model qorr politik, harron një lartësi e tillë e dikurshme, se janë kronikat e kohës ministër i brendshëm së tij në malësi. Por banka e parave ishte Lazarati.

Banka e një partie të vetme – prandaj duke e ditur mirë këtë gjë, akuzojnë të tjerët për fitore të zgjedhjeve me kanabis, sepse e kanë bërë vetë lirshëm fare. Po - dhe duke u shprehur lideri i madh i tyre për Lazaratin “ishte vendimi im full stop” dhe një nga ministrat “full stop” ishte dhe Presidenti i ardhshëm më i politizuar i Shqipërisë mbas 1990-tën. As Ramiz Alia nuk ishte shërbëtor i PPSH-së, si njeriu që sot alarmohet për “sigurinë kombëtare” kur kapet kokaina nga policia shqiptare.

Një njeri i tillë ish ministër i Brendshëm që krijon “rezik sigurie kombëtare” kur policia kam drogën kokainë – do të thotë se ka jo vetëm probleme partishmërie të pakrahasueshme, por dhe një inat patologjik me të huajt. Ai e di se të huajt miqtë tanë – kanë tashmë nën kontroll situatën. E di mirë se kanë dorë të lirë dhe gati-gati nuk “pyesin” më askënd në Shqipëri, por për këtë gjë i vjen një inat akoma më i madh. Nga vjen ky inat patologjik? Po sigurisht vjen nga patologjizmi politik i tij, si një person i pa merituar politikisht, i pa votuar realisht në popull dhe parti, i pa merituar si kontribut real politik në Shqipëri. Pastaj në rradhë të dytë, nga patologjia politike e partisë, e cila ka marrë fund së qeni një model demokratik në Shqipëri, në mos nuk ka qenë asnjëherë e tillë, në saj të babait të tij shpirtëror politik dhe katapultues në Presidencë, që është padyshim lideri maximus i PDSH-së.

Siguria kombëtare ka qenë e “pasigurte” në saj të tipave si ky! Njerëzve mediokër dhe pa asnjë ekselencë në asnjë drejtim! Partishmëria nuk është virtut dhe po të jetë - është dyshim i gjithmonshëm politik! Nuk ka asgjë që ta rrezikojë sigurinë kombëtare të Shqipërisë se kapen gjashtëqind kile kokainë nga policia shqiptare. Po - ka një tentativë për ta prishur sigurinë duke mbrojtur njerëzit që nuk duan që policia dhe drejtësia shqiptare, të jenë tashmë me partner të lartë të huaj dhe që aksionet e saj nuk dekonspirohen më si dikur. Policia shqiptare po pastrohet nga mbeturinat e dikurshme të mentalitetit parti në polici. Po dhe nga ky mentalitet, deri pak përpara pak kohe. Largimi i organizatës së partisë në polici, sjell më siguri kombëtare dhe ish ministri alarmant e kishte një organizatë të tillë partie, policinë që drejtoi për disa kohë.

Por mitomanët këtë gjë kanë të sigurtë – pasigurinë e tyre së qeni njerëz normalë në politikë dhe drejtim. Unë dua ta justifikoj një person të tillë, duke i thënë mitoman. E them kështu, sepse kam respekt për postin e lartë në të cilin ka qenë në

Shqipëri. Pseudologjia politike dhe fantastike e një personi të tillë ka “evente” ose ngjarje të përpunuara shpesh herë në grotesk, por dhe me qëllimin e keq politik të një gënjeshtre alarmante shumë pak probabile (e mundshme) dhe shumë shpejt të ngatërrueshme! Mistifikimi i të sotmes në rrezik kombëtar, është moment i një studim i K. E Treanor që sqaron natyrën komplekse dhe fantaziste të gënjeshtrave që zbulohen shpejt, të cilat përdoren për të marrë ndonjë leverdi politike, apo dhe të çfarëdollojshme sot. Nganjëherë shkon puna deri aty sa – pacienti e beson vërtetë marrëzinë e tij të nxjerr si mitoman apo gënjeshtar, i pa ndreqshëm zakonor dhe në patologjizëm gënjeshtar!

Asnjë rrezik dhe sidomos siguria kombëtare nuk ka rrezik sot në Shqipëri. As politikisht as ushtarakisht dhe as nga asnjë agjunkturë e huaj. Të gjitha janë alarme të njerëzve që realisht duhet të jenë në alarm nga vendosja reale e demokracisë ligjore në Shqipëri. Këtë alarm më tepër e kanë “mjeshtri dhe nën mjeshtri” i njeriut që thotë – siguria kombëtare në rrezik. Po pra, se policia ka kapur kokainën e madhe të Kolumbisë. Një ish ministër i Brendshëm që thotë kështu, nuk është vetëm mitoman, por unë nuk dua të shtyhem më tej. Sot po frikësohen shumë e shumë, ish ministra, ministra, presidentë, ish presidentë, ish kryeministra dhe po ashtu deputetë dhe njerëz të politikës. Kudo majtas dhe djathtas! Pa ndarje “krahine, feje dhe ideje” dhe mund të shtoj dhe gjinie e forme të paraqitjes së jashtme. Si thotë pra, i madhi Tano Banushi – me musteqe apo pa musteqe?! Kjo është siguria më e madhe kombëtare që kemi pasur deri tani. Siguri se SHBA-të dhe BE-ja, janë më shumë prezent te ne. Siguri se policia dhe prokuroria janë me agjensitë dhe vendet partnere – partner të vegjël, por të sigurtë. Kjo është siguri dhe do të vijë duke u rritur, sepse situata po rëndohet nga përpëlitjet e një klase politike dhe lidhshipi të keq, kriminal dhe korrumpuar! Një mitoman më shumë që flet nuk përbën ndonjë ndryshim të madh.

autorit të veprës.

Së pesti, themi me bindje se studiuesi dhe historiani, poeti e shkrimtari P. Milani, ka përvijuar dhe formësuar tashmë stilin e vet krijues për vepra të tilla; ai zotëron në shkallë të lartë metodën e kërkimit shkencor, shtruarjen e çështjeve dhe argumenteve që do të mbrojnë; arrin të dallojë me anë të gjuhës mendime e opinione midis personazheve; autori ka fituar aftësinë e masës së përshkrimit, sipas sekuencave dinamike; prej kohësh-ky pasionant i shkrimeve të tilla, ia del të ruajë raportet e duhura midis standardit gjuhësor dhe idiomës dialektore, deri edhe të folmet individuale, të veçojë dialogun, të ruajë linjat e veprimt të ngjarjeve të sjellë shprehje të figur-

shme të ndërtaura nga mbresat e jetës e aq të kuptueshme. Nuk mungojnë në prozën e P. Milanit frazeologjitë, thënie nga njerëz të shquar dhe përgjithësisht, fjalët e zgjedhura, si dhe prurje të leksikut të pasur të krahinës ku zhvillohen ngjarjet. Mjaft pamje nga albumi i fotografive të prof. Kolës, vendbanimit e origjinës së tij, foto të shokëve e miqve, si dhe faksimilet e dokumenteve, ia shtojnë vlerën monografisë për heroin e Dukagjinit.

E gjashta, është një risi që autori i kësaj veprë – biografi e një heroi dhe e një kohe, siç mund të quhet, ka gjurmuar dhe ka mbledhur edhe krijimtari letrare e studimore të prof. Kolë Prelës, çka tregon se universitari i ardhur nga Firencja, ishte një pedagog në lartësinë shkencore të

kohës, studionte dhe botonte në organet e periodikët që dilnin, ai ishte aq aktiv për çështje teorike e letrare, sa kishte nisur të njihej në opinionin letrar edhe si kritik: për analizën ndaj artit të Mjedës e të Fishtës; ishte shfaqur aq polemik edhe kundër F. Cordignano-s, madje del se kishte qenë edhe recensent i broshurës së 20 profesorëve të Liceut kundër shkrimit të misionarit italian, në apologjinë “Cordignano në gjyq para botës”.

Punimi monografik i shkrimtarit dhe publicistit Prelë Milani, autor i disa librave për personalitete të shquara të kombit tonë, për ngjarje të shënuara, pak e aspak të njohura, që lidhen me qëndresën e Malësive të Veriut, veçanërisht, në mbrojtje të tokave shqiptare nga lakmitë e

sulmet e shteteve fqinje, si dhe në mbrojtje të identitetit tonë kombëtar, është dëshmi e punës së madhe që ka bërë e po bën autori për vendosjen e mjaft ngjarjeve në realitetin historik kur u zhvilluan, ajo është pa dyshim, një rivlerësim edhe për luftëtarë dhe intelektualë pak të ndriçuar në veprat e tyre, ose edhe krejt të mohuar për vite me radhë. Në mbyllje, dëshirojmë të themi me keqardhje se autori nuk ka pasur mundësi të botojë më tepër se 200 kopje, një tirazh që s’mund të kënaqë kërkesat e lexuesve për figura me aq vlera njohëse, si kjo e prof. Kolë Prelës.

Ju falem nderit

NDAHET NGA JETA PROFESOR MAHIR HOTI

Pak ditë më parë është ndarë nga jeta Profesor Mahir Hoti, ish Rektor i Universtitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Sëmundja e pamëshirshme e mori në kohën kur familja, dhe shoqëria kishin shumë nevojë për të, por jeta kështu e ka.

Mahir Hoti u lind në një familje Shkodrane, më 15.1.1948. Ka përfunduar studimet në Univeristetin e Tiranës në vitin 1970. Në vitin 1999, fiton titullin "Profesor Doktor".

Gjatë 35 viteve në arsim ka kryer të gjitha detyrat në sistemin arsimor në Shqipëri, që nga mësues dhe në drejtues shkollë në arsimin parauniversitar, pedagog në Institutin e lartë Pedagogjik të Shkodrës, kryeinspektor arsimit për rrethin e Shkodrës për disa vite, pastaj përsëri pedagog në Univeristetin e Shkodrës, Rektor i këtij Universtitetit për dy mandate dhe për ta mbydhur përsëri pedagog në Univeristetin e Shkodrës.

Ndihmesa dhe prania e Prof.Dr. Mahir Hotit do ti mungojë botës akademike, kolegëve, miqëve dhe bashkëpunorëve të shumtë të tij. Ai ka lënë nga kontribut intelektual me shumë vlerë të formuar gjatë karrierës së tij për Shkodrën dhe

Shqipërinë.

Profesor Mahiri nuk u mbydh në zyrën apo katedrën ku punonte, por kishte aftësinë që të përfshihej edhe në projekte të tjera jashtë procesit mësimor. Ai ishte President i forumit të Liqenit të Shkodrës, ishte Kryetar i Shoqatës Shqipëri-Austri, mbate lidhje me shumë forume dhe shoqata, në të cilat merrte pjesë gjallërisht dhe jepte mendime shumë të vyera.

Profesor Mahiri mbydhi sytë përgjithmonë në qytetin e tij të lindjes, duke lënë pas një mal me kujtime dhe punë të mira. Prof. Mahir Hoti është zgjedhur në 100 arsimtarët më të mira të botës në vitin 2006, emri i tij do të renditej në në sallën e Qendrës Ndërkombëtare të biografive në Cambridge të Anglisë, përkrah shumë përkrah shumë personalitetëve të tjera nga gjithë bota, të cilët kanë dhënë ndihmesë të vyer në fushën e arsimit. Gjatë kohës së drejtimit të tij, Universtiteti i Shkodrës është ngritur në një stad më të lartë procesi i mësimdhënies, por dhe janë nënshkruar shumë marrëveshje bashkëpunimi me universitete të ndryshme të Ballkanit dhe të Evropës.

Profesor Mahiri ishte gjithnjë i gatshëm



për të fliste, më kompetencë shkencore dhe metodike, për fushën e arsimit dhe arsimimit, problematikën e tij, por edhe për probleme të tjera shoqërore, historike, gjeografike, mjedisore, etj

Në fillimin e viteve '70 Profesor Mahir Hoti ka punuar për disa vite si drejtues shkollë në Theth dhe në Shkollën e Mesme në Breglumi-Shalë. Puna

organizative, metyodike dhe shkencore e tij, marrëdhëniet me nxënësit, prindërit dhe drejtuesit e kohës qenë shumë të mira. Puna e tij ndikoi në rritjen e nivelit të mësimdhënies veçanërisht në Shkollën e Mesme në Breglumi. Përvoja e tij vlejti edhe për breza të tjerë të mësuesve. Profesor Mahiri ka qenë gjithnjë bashkëpunor i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", dhe për këtë shoqata jonë e ka shpallur Anëtar Ndëri të Shoqatës, dhe së fundi i kemi dorëzuar në shtëpi, pasi nuk mund të vinte vetë për ta marrë për shkak të sëmundjes, medaljonin "100 Vjet Arsim e Kulturë në Dukagjin". Në ditën e varrimit një grup nga kryesia e shoqatës mori pjesë në homazhet e fundit duke i dëguar edhe një kurorë në emër të shoqatës.

Profesor Mahir Hoti do të mbetet në mënyrë të përhershme në kujtesën e familjarëve, të miqëve, bashkëpunorëve, dhe pa tjerër edhe të Dukagjinit e dukagjinave, Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", kryesisht së saj, dhe redaksisë së gazetës "Dukagjini".

Luigj SHYTI

GJELOSH LUSHI ATDHETARI I MARTIRIZUAR

Gjelosh Lushi ka lindur në vitin 1913. Ishte i madhi në radhe, ndër dy djemtë që pati Lush Gjelosh Ujka. Sipas të dhënave nga ish bashkëmoshataret e tij, Gjeloshi hynte tek ata njerëzor shpotar e gaztor në çdo moment. Gjeloshi, në moshe fare të mitur mbeti jetim, pasi bashke me babën e tij vdiqën edhe katër pjesëtar familje nga epidemia e tmerrshme e kolerës në vitin 1916. Kështu që Mark Milani, që e kishte dy herë kushëri Lush Gjeloshin, rriti tre palë jetimë: 4 fëmijët e vet, 2 të Lush Gjeloshit dhe tre të Sokol Ujkës.

Gjelosh Lushi duhet vlerësuar në dy aspekte: E para, se kapi pushkën pa asnjë lloj hezitimi kundër çdo lloj pushtuesi dhe së dyti, në planin tjetër duhet vlerësuar si demokrat i vërtetë që u martirizua në altar për demokraci. Në intervalet kohore 1937 - 39 arrestohet dy herë nga qeveria zogiste, por lirohet me ndërhyrjen e Kolë Ndout të Shalës. Ka marrë pjesë aktive në Luftën e Gurit të Kuq në vitin 1941. Ai ishte në krye të listës rendore të partizanëve dukagjinave dhe njëkohësisht nga më të vjetrit e qarkut Shkodër. Në formimin e çetës partizane në Pepsuj ishte figurë qendrore bashke me Prof. Kolë Prelën, të cilit iu gjet në krah në të gjithë veprimtarinë e tij legale dhe ilegale. Ai qe avokati i profesorit në parandalimin e gjakderdhjeve e vëllavrasjeve, në moment mjaft kyçe për banorët e Dukagjinit. Gjelosh Lushi ka qenë luftëtar i Batalionit "Perlat Rexhepi", i Grupit të Shkodrës dhe i Brigadës së 27-Sulmuese.

Në gazetën "Koha e Re" Shkodër, më 3 Shkurt 1945 lexojmë "Edhe Dukagjini me 1. 2. 1945 në ditën e madhe historike, ditën e hymjes në radhët tona të çelika të pushtetit demokratik shqiptar...

Komandanti i rrethit Gjon Marashi hapi mbledhjen tue shpjegue rendësinë e madhe të këtyre zgjedhjeve...mandej thjeshte paraqiti delegatin e KNÇL të Prefekturës Shkodër Mark Ulin. Delegati foli mbi vuajtjet e popullit shqiptar në të kaluarën, pastaj shpjegoi detyrat dhe rëndësinë e këshillit që po zgjidhej. Zgjedhjet filluan dhe u bënë shumë propozime. Nga të gjitha propozimet u formua një listë prej 40 vetësh. Prej këtyre u zgjodh edhe Kryesia e KNÇL të Nënprefekturës së Dukagjinit. Në këto zgjedhje, kryetar u zgjodh Gjelosh Lushi".

Gjelosh Lushi, ndonëse ishte Kryetar i Këshillit NÇL të N/Prefekturës Dukagjin mori pjesë në një mbledhje të zhvilluar në Karmën e Bobit të zhvilluar nga një grup nacionalistësh në ilegalitet. Gjeloshi ishte ftuar nga disa miq të tij. Kjo difton qartë se Gjelosh Lushi e kishte ndarë përfundimisht mendjen të luftonte si ta lypte nevoja kundër diktaturës komuniste. Ky veprim ishte një sfidë midis dy sistemeve ku humbja do të thoshte: Vdekje! Shtysë për këtë u bë edhe arrestimi i shokut të tij të ngushtë Prof. Kolë Prela, për të cilin është shprehur "Unë Kolën e kam dashtë ma shumë se çdo njeri tjetër dhe për të un bajsha çdo send, sikur për këtë arsye u lidha me të dhe fillova të punoja si më thoshte ky. Pasi rrezuan Kolë Prelën, mu prish qefi mjaft dhe mbeta as andej as këtej".

Shumë shpejt sigurimi i shtetit do të binte në gjurmët e këtij aktiviteti konspirativ. Për konçidencë arrestimi i tij u bë me 21 qershor 1946, ditë kur në Pyll të Shoshit u arratis Lekë Vojvoda dhe Bek Delia pasi vrau tre ushtarët e mbrojtjes duke u arratisur bashkë me bajraktarin e Shoshit, Lulash Gjeloshin. Në akt-akuzën

ndaj tij Nr. 402, Shkodër me 20 Korrik 1945 thuhet: "Duke qenë në shërbim të pushtetit popullor, si Anëtar i Gjyqit në Dukagjin, tu përfitue nga kjo pozitë ka sabotuar punën q' ka besuar populli



dhe ka hedhur parulla helmatojnëse kundra pushtetit të sotëm, me qellim që të krijonte pakënaqësira në popull ta përçante e ta largonte nga pushteti i tij. Në lidhje dhe në bashkëpunim me të arratisurit kriminel lufte dhe armiq të popullit Gjergj Vatën dhe Mark Malën është munduar dhe përpjekur që të jenë gati për t'i rënë pas shpine qeverisë. I pandehuri njihet si element i rrezikshëm pasi ka tradhtuar interesat e popullit".

Gjykata e Larte ushtarake e formuar prej Major Frederik Nosi (Kryetar);

Kapiten i parë Veleidin Zeneli (anëtar); Kapiten i pare Nexhat Hyseni; Prokuror, Kapiten i Parë Nevzat Haderi asistuar nga sekretari Thoma Rino shqyrtoj dhe la në fuqi dënimin e dhënë me vendim Nr. 376, datë 07. 09. 1946 të Gjykatës Ushtarake Shkodër, që përmban ndëshkimin me vdekje të të pandehurve: Gjelosh Lushi nga Shoshi i Dukagjinit, Gjon Vata nga Shala e Dukagjinit, Zef Nika nga fshati Nicaj-Shalë. (Tiranë, 19. 09. 1946. Ky radiogram është firmosur edhe nga Komandanti Suprem i asaj kohe, Enver Hoxha. Të dënuarit u pushkatua me datën 11, 10. 1946, ditën e Premte, ora 5 para dreke. Ekzekutimi u bë me plumb në kokë në vendin e quajtur "Zalli i Kirit", Kryetari i Gjykatës Ushtarake, kapiten Mustafa Iliazi.

Te nderuar miq! A kemi të drejtë të themi se Shqipëria, në emër të cilës betohen gjithë ditën e lume, politikanët tanë, mund të quhet fare mire toka e njerëzve pa varre? A kemi të drejtë të themi se në këtë vend sa të dashur aq edhe të urryer, si në të shkuarën si në të sotmen: Ferri qëndron brenda nesh, ndërkohë që shpikim çdo ditë armiq e stërrarmiq për të mbuluar fajësinë tonë për të zezat që i mbollën dhe vazhdojnë t'i mbjellin këtij vendi, kësaj toke ... dikur të premtuar! A ka ndërjegjeje ndër ne, apo jemi kthyer të gjithë në zgavra memoriesh e ushtarësh të bindur ndër llogore turpesh të partive politike dhe të gatshëm për "beteja të reja mes vetit". Përvojën e duhur negative e kemi dhe na e ushqejnë çdo ditë në mënyrë hierarkike. Ndaj duhet zgjuar vetëdija jonë, sepse gjërat që harrohen e nëpërkëmbën edhe mund të riinstalohen!

LAZER KODRA

AFORIZMA TË FAMSHME BOTËRORE

- Budallenjtë prej Adamit e këtej janë në mazhorancë. **C. Delavigne**
- Gruaja juaj është një trëndafil-i thanë një poeti të verbër! E imagjinoj nga gjembat-u përgjigj ai! **A. Karr**
- Gruaja ka një pozicion shoqëror midis shërbëtores dhe dashnores... pak më lart se shërbëtorja e pak më poshtë se dashnorja. **G. Prezzolini**
- Parajsën e preferoj për klimën, Ferrin për shoqërinë. **M. Twain**
- Zoti është qenia e vetme që, për të mbretëruar, nuk ka nevojë të ekzistojë. **Baudelaire**
- Njerëzit tepër katolikë arrijnë lehtësisht të jenë pak paganë dhe aspak kristianë. **A. Karr**
- Nxitoni më ngadalë. **A. Manuzio**
- Çfarë bëhet një mendjemadh pa fudullëkun e tij? Provoni t'i hiqni krahët gjinkallës: do mbetet një krimb. **Chamfort**
- Idealet janë gjëra të rrezikshme.

- Është më mirë realiteti: të dhëmb, por vlen më shumë. **O. Wilde**
- Vdekja, më e egra e të gjitha të këqijave, nuk ekziston për ne. Kur jetojmë ne, vdekja nuk është, ndërsa kur është ajo, nuk jemi ne. **Epikuro**
- Dikur rreziku ishte që njerëzit të bëheshin skllëvër; rreziku i së ardhmes është që të bëhen robotë. **E. Fromm**
- Pasuritë shërbejnë kur janë në duart e dijetarëve. Në duart e një teveqeli, komandojnë. **Seneca**
- Paraja mund të japë shtëpi, por jo vatër familjare; mund të blejë një shtrat, por jo ëndrrën; mund të blejë një orë, por jo kohën; mund të blejë një libër, por jo ndërgjegjen e diturisë; mund të blejë një post, por jo respektin; mund të blejë doktorin, por jo shëndetin; mund të blejë shpirtin, por jo jetën; mund të blejë seksin, por jo dashurinë!

- Thënie kineze**
- Një idiot i varfër është thjeshtë një idiot, kurse një idiot i pasur është vetëm një i pasur. **Paul Zafitte**
- Sa më i pasur të jetë një njeri, aq më lehtë bëhet maskara. **Gilbert Keith**
- Paraja mbulon qindra të meta. **Proverb kinez**
- I pasuri është si një taketuke, sa më shumë mbushet, aq më e pistë bëhet. **Proverb arab**
- Njerëzit falsifikojnë paratë, paratë falsifikojnë njerëzit. **Karl Farkas**
- Më thuaj, ç'rrugë të çon te paraja? - Shumë thjeshtë: merr majtas, pastaj djathtas...pastaj nga të gjitha anët! **Viktor Tissot**
- E njeh veten? Mund të thuash 'po', kur do të zbulosh në vetvete më shumë defekte sesa të shohin të tjerët. **Kafka**
- Ka njerëz që bëhen kafshë, sapa fillon t'i trajtohen si njerëz!

- V. O. Kluçevskij**
- Turma është nëna e tiranëve. **Diogene**
- I adhuroj partitë politike; janë të vetmet vende ku njerëzit nuk flasin për politikën. **O. Wilde**
- Njeriu është nga natyra një kafshë politike. **Aristotele**
- Janë të shumta rrugët që të çojnë te pasuria, shumica e tyre janë të pista. **Ciceroni**
- Pasuria është këmbë e ndyrë e pushtetit. **Nietzsche**
- Dikush besonte aq shumë se do të jetonte edhe pas vdekjes, sa që kur vdiq pasurinë ia la trashëgim vetes. **Anonime**

Mblodhi e përgatiti për botim
Lazer KODRA

Një kafe me Antonin...

Të nderuar të pranishëm, zonja dhe zotërinj, familjarë dhe të afërm të gjakut, shokë dhe miq të Anton Grishajt në nderim të të cilit sot po përcjellim "këtë Kafe me Antonin...". Në emër të Shoqates së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Malësisë së Madhe", po aq edhe të familjes Grishaj, dua t'u shpreh gjithë mirënjohjen për pjesëmarrjen tuaj në këtë ditë të veçantë, ndryshe të një bashkëpunimi të llojit të vet mes nesh si institucion i krijuesve malësorë dhe familjes Grishaj, ndryshe në Përkujtimoren e organizuar në njëvjetorin e ndarjes fizike nga jeta të shkrimtarit, kineastit dhe publicistit z. Anton Grishaj."

Ka ndarje dhe ndarje nga jeta. Ka ndarje që të marrin me vete si rrezatim ndjeshmërie, respekti dhe investimi moral, qytetar dhe intelektual, që mbeten të pashlyera, jo thjesht brenda një rrethi të ngushtë jetësh njerëzore, por shumë më gjërë. Kjo e fundit ndodh pikërisht atëherë, kur ndarja nga jeta konvertohet në memorjen e njerëzve nga një fjalë në vete në ngjizjen si memorie e përhershme respekti, dashurie dhe kumti jetësor. Një të tillë ndarje përjetoj familja Grishaj, në kryeqytetin tonë, Tiranën më 17 prill 2017. Pikërisht në këtë ditë, ndahet nga jeta gazetari dhe poeti, producenti dhe skenaristi, telekronisti i parë i televizionit shqiptar për Malësinë e Madhe, bashkëpunëtori dhe kolegu nga më të vlerësuarit në jetën e gazetarisë televizive shqiptare, frymëzuesi i idealeve demokratike dhe po aq poeti Anton Grishaj, që diti të sfidojë keqas moralisht edhe vdekjen duke evokuar deri në çastet e fundit të jetës dimensionet e paimagjinueshme të shpirtit:

Në mugëtirën e natës
Kam parë vetëtimat
Tek skuqnin
E tek shqyenin Qiellin
E s'jam trembur

do të shprehej me gjuhën e shpirtit në librin e tij, "Amaneti i pa lënë", si një amanet për të gjithë ata që i deshi dhe e deshën, që jetuan dhe shoqëruan nga afër apo në distancë në tërë jetën e tij, vërtet të



shkurtër, por interesante, si i lindur për të komunikuar me buzë në gaz me njerëzit... Jeta e tij qe, jo thjesht, një jetë e bukur prej partneri dhe familjari, prej poeti dhe kineasti, prej qytetari apo prej veprimtari shoqëror, por një jetë dinjitoze, gjithë dashuri për njeriun, për gjakun, shokët dhe miqtë e tij, ndryshe një jetë gjithë dashuri për jetën. Antoni lindi në fshatin Grishaj, u rrit mes këtij mjedisi, i rrethuar nga natyra, sa mal, sa fushë, në një familje të thjeshtë fshati, gjithë ngrohtësi jete. Arsimin 8-vjeçar dhe të mesëm e përfundoi në qytezën e Bajzës, mbi këtë bazë kryen studimet e larta pranë fakultetit të agronomisë, në Universitetin e Kamzës, ndërkohë që tek ky djalosh do të spikaste dukshëm edhe prirja instinktive si vizion

estetik, apo si bukuri e fjalës. Njeri me natyrë të hapur, artist i lindur. Si fati i lumtur i jetës ka hapur krahët e saj, thuajse hyjnor, trokitja në zemrën e tij e dashurisë për Dritën, ish-studenten e fakulte-

tit të veterinarisë. Dritë e diell do të jetë ky çift, me dy pëllumbat e vet: Adin dhe Aidën, fryt i një dashurie të çiltër, falë së cilës, edhe pse krejt të rinj, nën shembullin e nderuar të dy prindërve të tyre, do të ofrojnë modelin e gjetjes me dinjitet të vetvtes. Adi do të diplomohet shkëlqyeshëm për regji televizive në Universitetin e Londrës, ndërsa Ida pritet të diplomohet, madje si ekselente e ambasadë gjermane, në Universitetin e Mynih për jurisprudencë. Antoni dhe Drita, një çift model në punë dhe në jetë. Mes shumë arritjesh kujtojmë se në konkursin kombëtar të vitit 2000, në Teatrin Popullor, ku merrnin pjesë konkurentë të shquar, Grishaj do të konkurojë me sukses duke fituar Çmimin I me dokumentarin "Gjakmarrja". Hap

pas hapi sukseset e tij bëjnë që Grishaj të kalojë, shumë shpejt nga filmi dokumentar tek ai artistik. Madje, gazetari veteran i televizionit shqiptar Marash Mirashi, miku i tij i pranishëm, A. Grishajn do ta vlerësonte si themeluesi i telenovelave shqiptare. Numri i atyre që kanë dëshirën të thonë fjalën e tyre të ngrohtë për marrëdhëniet me Antonin dhe kontributin e tij për të gjithë ata që e njohën është jo i zakonshëm. Fjalë zemre nga shkrimtarët dhe artistët malësorë, nga shokë dhe miq, ndryshe nga gjithsecili që nuk do të mësohet" në vetvete me faktin e hidhur të një mungese që do të ndihet gjatë, të një mungese që gjithnjë do të na motivojë me shembullin e tij si model i qytetarit, familjarit shembullor, gazetarit të palodhur dhe poetit plot ndjesi shpirti, mik i të gjithëve.

Jo rastësisht Shoqata e Shkrimtarëve të Malësisë së Madhe, më 24 shkurt 2018, i propozoi Këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" me këtë motivacion "Për kontributin e dhënë si gazetar, publicist, krijues, producent dhe kineast, njehëresh edhe si lartësim i vlerave përfaqësuese të Malësisë së Madhe", titull që u bë realitet me vendim të këshillit bashkiak më 23. 03. 2018.

Ky ishte Anton Grishaj, zëri ynë i veçantë, si qytetari, miku, shoku, telekronisti, kineasti, producenti dhe krijuesi që na mblodhi në këtë përkujtimore, si stacioni i një dhimbjeje që do të ndihet gjatë mes nesh, si model inkurajimi me modelin që na ofroi jeta dhe vepra e Antonit, si shtegtim i shpirtit të etur për dashuri njerëzore, dashuri për vendlindjen dhe për njerëzit, si shprehje e kthjellët e dashurisë për jetën. Ngushëllime familjes së tij: Dritës, bashkëshortes së tij të jetës si dhe dy pëllumbave të tij të mrekullueshëm, Adit dhe Idës, ndryshe trinomit të tij të shenjtë!

I nderuar qoftë kujtimi i jetës dhe veprës së tij!

Kadri Ujkaj

Zadrimea: Vendlindja ime

“KURSE ATDHEU YNË ËSHTË QIELLI, NGA PRESIM SE VJEN SI SHËLBUES JEZU KRISHTI ZOT”. (FIL. 3, 20)

Disa të dhëna të përgjithshme

Zona e Zadrimës shtrihet në veri të qytetit të Lezhës dhe, sipas historianëve, fillon tek ura “Plak Gjon” poshtë fshatit Mërqi dhe shkon deri në malin e Zadejës.

Sidoqoftë, kufiri verior nuk duhet të jetë kështu, sepse edhe në veri të Vaut të Dejës kemi fshatra deri në Rrenc, si: Spatharin, Ganjollën, Gurin e Zi, Jubanin e të tjerë, që kanë të njëjtat veshje e zakone me Zadrimën.

Mendohet që emri Zadrimë ka ngelur që nga pushtimet sllave të shekullit të XIII-të: në fakt etimologjia e fjalës Zadrimë vjen nga *Za Drina*, që përkthehet “*Matanë Drinit*” ose “*Përtej Drinit*”.

Në pjesën lindore, Zadrima kufizohet nga male, duke filluar nga mali i Mërqisë, më pas vazhdon me Malungu dhe kulmon me majën më të lartë, Velën, me lartësi 1171 m mbi nivelin e detit. Në pikën më të lartë të malit të Veles, donë Antonio Sciarra, misionari i palodhur italian, i cili kushtoi rreth 20 vitet e fundit të jetës kryesisht për rimëkëmbjen e popullit të Zadrimës, vendosi një trupore të Zojës së Bekuar, të cilën e quajti Zoja e Veles.

Ky vargmal i sipërpërmendur vazhdon me Kreshtën deri te Shita e Hajmelit. Në përfundim kufizohet me lumin Drin, por edhe ky kufi nuk duhet të jetë i saktë, sepse edhe në përfundim të Drinit kemi fshatra me veshje e zakone të ngjashme, nga Kukli e deri në Bërdicë.

Si zonë i ka tri format e relievit: malor, kodrinor dhe fushor. Por, për nga sipërfaqja, kryeson relievi fushor, i cili fillon nga lindja rrëzë maleve dhe vazhdon deri në lumin Drin. Por, edhe relievi fushor ka mjaft kodra, duke filluar nga kodra e Rraboshtës, e Kishës dhe e Vezirit në fshatin Piraj. Kodrat vazhdojnë edhe në fshatrat Blinisht, Baqel, Kodhel, Kotërr, Dajç e Dragushë. Kodrat më të larta janë në Kodhel e Dragushë.

Në lidhje me strukturat e tokës, Zadrima ka tri: super-argjilore, argjilore dhe argjilore-ranore. Ndërsa toka humusore ka shumë pak.

Tokat super-argjilore kanë zonat sipër kanalit të ujërave të larta që fillon poshtë fshatit Nënshat e vazhdon deri në Lezhë ku derdhet në lumin Drin. Po këtë strukturë toke kanë edhe kodrat e zonës fushore. Këto toka kanë edhe zall, duke filluar nga Rraboshta e deri në Hajmel. Tokat poshtë kanalit të ujërave të larta në përgjithësi janë toka argjilore deri në afërsi të lumit Drin ku kanë strukturë argjilore-ranore. Edhe në malet e kësaj zone, përveç masave shkëmbore, toka është super-argjilore.

Klima

Zona e Zadrimës ka klimë mesdhetare me dimër të butë e verë të thatë. Bora bie shumë rrallë dhe zakonisht ajo zgjat 2 deri në 3 ditë dhe jo më shumë. Reshjet kryesore janë reshje shiu e nganjëherë bie edhe breshër. Ka raste që breshëri bie edhe në stinën e verës dhe shkakton mjaft dëme,

sidomos në frutikulturë dhe në bimët e arave. Sasia më e madhe e reshjeve bie në gjysmën e dytë të vjeshtës dhe gjatë dimrit. Pjesa tjetër është në gjysmën e parë të pranverës.

Muaji më i ftohtë është janari, por jo shumë i ftohtë, sepse temperatura mesatare



nuk bie në 7°C. Muaji më i ngrohtë është korriku, ku temperatura më e lartë arrin në 40°C (mesatarisht është 24-25°C). Sasia e reshjeve në këtë zonë është më e lartë se mesatarja e Republikës. Sasia mesatare vjetore e reshjeve ndryshon nga 1300 deri në 1800 mm. Zonën e Zadrimës e përshkojnë disa rryma ajrore, por më të shpeshta janë verilindja që njihet me emrin Murrilan dhe jugperëndimi që njihet me emrin Shirok. Këto erëra e kanë ardhjen nga gryka e Zadenjës (Murrilani) dhe nga gryka e Lezhës (Shiroku).

Këto erëra shpeshherë shndërrohen në stuhi duke shkaktuar edhe dëme. Por ka edhe rryma të tjera ajrore që emërtohen sipas drejtimit nga vijnë. Juglindja emërtohet Velnjake, lindja merr emrin Kreshtane, sepse vjen nga Kreshta. Era që vjen nga veriu emërtohet Shkodrinë dhe veriperëndimi Kuklane (se vjen nga drejtimi i Kuklit).

Ujërat

Për ujërat mund të themi se përmbledhen sintetikisht në 4 grupe:

Burimet (janë më të përhapura), Përrenjtë, Lumenjtë e Kanalet, Rezervuarët.

Vendburimet më të mëdha janë në zonat malore. Nga krojet malore më të mëdhenjtë janë: kroi i Shën Eufemisë në Kallmet (që buron nga Altari i Shenjtërores së Eufemisë dhe përshkon gjithë Kishën që është cak për mijëra shtegtarë nga gjithë Shqipëria pikërisht se ai krua konsiderohet si krua mrekullibërës nga të gjithë besimtarët që e njohin atë vend), në krahun verior të Veles dhe Gurra e Hajmelit në veri të Shitës së Hajmelit. Kjo e fundit, kur ka shumë reshje, turbullohet e në verë shkon drejt tharjes. Sipas studiuesve hidroteknike, po të pritët shpati, prurjet e tij janë 100 litër/minutë. Vendburimi i Shën Eufemisë, u diskutua

në vitin 1978 që t'i rritej kapaciteti prurës i ujit në mënyrë që të furnizonte gjithë Zadrimën me ujë të pishëm, por projekti nuk u zbatua. Fakti që ky projekt për ta bërë Kroin e Shën Eufemisë si ujësjellës në më të madh të Zadrimës nuk u realizua la shumë dyshime dhe krijoi legjenda

nga 3 kanale të mëdha kulluese:

Kanali i ujërave të larta, që fillon nga fshati Nënshat e shkon deri në Lezhë, ku derdhet në lumin Drin;

Kanali poshtë kodrave, që fillon mes fshatrave Kotërr e Dajç dhe derdhet në Dri, poshtë fshatit Rraboshtë;

të ndryshme në popull. E vërteta është se, meqenëse atëherë, shteti totalitar komunist, duke mos pasur aftësitë financiare për të kryer këtë vepër, nxori justifikimin se uji është gëlqeror. Mendohet se edhe punëtorët, duke mos dashur ta përdorin këtë burim mrekullibërës për projektin e sipërpërmendur, në respekt të normave të besimit popullor, lejoi të kalojë ky justifikim duke bërë që uji i Kroit të Bekuar të kufizohet vetëm për fshatin e Kallmetit. Kroi i Shën Eufemisë është një Legjendë e vërtetë, dhe në këtë aspekt mund të konsiderohet si një kapitull më vete, e në një moment tjetër mund të thellohet e zgjerohet historiku i tij.

Krojet e tjera janë më të vogla e thahen gjatë verës. Zona malore përshkohet nga shumë përrenj duke filluar nga fshati Mërqi e deri në Shitën e Hajmelit. Janë përrenj shumë të rrëmbyeshëm e mjaft të rrezikshëm. Përrenjtë më të mëdhenj janë në zonën e Kallmetit (përroi i Qershisë dhe i Mallojës). Përroi më i rrëmbyeshëm është përroi i Gjatores (lagjia në pjesën jugore të fshatit Kallmet i Madh).

Në përfundim fusha e Zadrimës kufizohet nga lumi Drin, i cili përshkon gjithë zonën nga Vau i Dejës e deri në Lezhë. Në periudhën e vjeshtës dhe të pranverës prurjet e këtij lumi janë të mëdha, sa që shpeshherë del nga shtrati, bllokton kanalet dhe përmyt fushat.

Lumi tjetër është Gjadri, që fillon nga zona Vig-Mnelë dhe përshkon gjithë zonën veriore të Zadrimës, derisa derdhet në Drin në fshatin Gjadër. Deri në vitet 1960 ka shkakuar përmytje. Në vitet 1960 u ndërtua argjinatura sipër fshatit Naraç, duke i zbutur shpejtësinë, duke i ndalur kështu vrullin e rrëmbyeshëm. Në dimrin e vitit 1963 Gjadri fatkeqësisht theu argjinaturën dhe përmyti gjithë zonën.

Territori i Zadrimës përshkohet edhe

Kanali i zonës fushore, që fillon poshtë fshatit Dajç dhe derdhet në Dri, poshtë fshatit Piraj (te Ura e Shkinës).

Kjo zonë ka edhe 3 rezervuarë: një në Kallmet dhe dy në Fishtë. Më i madhi është rezervuari i Kallmetit me kapacitet vaditës 900 ha.

Gjallesat: bimët dhe kafshët

Në këtë zonë rriten rreth 200 lloje bimësh spontane, ku dominojnë bimë të familjes bishtajore dhe bimë të familjes kompozite (latinisht: Compositae).

Në këtë zonë ka rreth 130 lloje bimësh mjekësore, ndërsa drurët do të mund t'i ndanim në dy grupe, sipas relievit:

Drurët e zonës malore, që janë: Dushqet (lisi i butë, qarri e më pak bunga e zezë), Frashëri i Zi, Shkoza, Panja (kjo pothuajse është zhdukur nga prerjet).

Drurët e zonës fushore, që janë:

Plepi, Shelgu, Frashëri i Bardhë, Vidhi, Dardha e Egër (në kodra), Mrina e Kuqe (shumë pak), Murrizi njëbërthamësh.

Nga shkurret kryesojnë në zonën e fushës: Ferrmana (me frut të zi, e më pak ajo me frut të kaltër), Mrina e Bardhë, Driza (që në këtë zonë njihet me emrin Ferrkuqe).

Në zonën malore nga shkurret, përveç tyre, ka edhe Shqopë, Mare e pak Shkeme.

Në botën e kafshëve nga jo-rruazorët, dominon për nga numri i llojeve, klasa e kandrrave (insekte).

Tipin e rruazorëve e ndajmë sipas klasave:

- Peshqit: Dominojnë krapi, mlyshi, ngjala e në periudhën e verës edhe qefulli e levreku. Pas viteve 1980 ka shtim të madh të karasit.

- Amfibët: prej tyre ka pak lloje dhe janë Bretkosa Ballkanike dhe Thithëlopa e Bretkosa e Gjellbër.

- Zvarranikët: me gjymtyrë (Hardhuca e Gjellbër apo Zhapiku

Termetët, përbindsha të thellësive të mëdha



Nga Luigi Temali

Erdhi në rrjedhjen e vet të kohës 15 Prilli i vitit 1979. Ishte e Diela e Pashkëve. Një mëngjes i bukur pranveror. Rreth orës 6 e 45 minuta u nisa me biçikletë nga shtëpia për në ndërmarrje për nxjerrjen e bilançit të Drejtorisë P.T.T Shkodër. Në momentin fatal ora 7 e 19 minuta, kur po shkruaja: "Për stornim artikulli nr.....", një goditje e fuqishme më hodhi nga zyra e financës e katit të

dytë drejt shkallëve përjashta!

Termeti me magnitudë 7.2 dhe intensitet në epiqendrë 9 ballë e gjysëm goditjen më të fuqishme e dha në detin Adriatik, në afërsi të qytetit Petrovac (Mali i Zi). Pas disa minutave u dëgjuan burijat trishtuese të makinave të ndihmës së shpejtë, të cilat lëviznin me shpejtësi "rufe" nga Zona e Nën Shkodrës drejt Spitalit Rajonal të qytetit. Rreth orës 11-të paradreke u thirrë një mbledhje e jashtzakonshme e të gjitha strukturave drejtuese të rrethit për përballimin e kësaj fatkeqësie të madhe.

E tërë Shqipëria dhe e gjithë Bota u njohën me përmasat e pasojave katastrofike të tërmetit tetë ballësh i shkallës rihter i 15 Prillit 1979. Ishin ç'vendosur formacione kolosale të shtresave nëntokësore, që ndodhën disa dhjetëra km në thellësitë e Tokës, të cilat fokusin e goditjeve fatale e paten në një zonë të gjerë të detit Adriatik, nga Shëngjini- Velipojë-Dajç-Ulqin e më tej. Rreth perimetrit të epiqendrës së tërmetit pati shkatrime drithëruese. U dëmtuan 17122 shtëpi banimi dhe objekte social-kulturore. Në rrethet e Shkodrës e të Lezhës totali i përgjithshëm arriti në 14686 ndërtesa, prej të cilave 2413 u shkatruan plotësisht. Mbi 100 mijë banorë mbeten pa strehë.

Termeti solli shkatrime të mëdha, sepse tronditjet e tokës ishin apokaliptike. Në Dajç e Velipojë Dielli u "mbulua" nga pluhuri, degët dhe gjethët e pemëve si

edhe nga gurët e madhësive të ndryshme, që zbriten furishëm nga malet e kodrat përrreth. Në disa vende u çatoke dhe mbi sipërfaqe doli një përzierje me ngjyrë të zezë (ujë i vluar, naftë e material të tjera). Mbi të gjitha termeti ishte një tragjedi me shumë viktima, dhimbje, lotë dhe vuajtje njerëzore. U vranë 35 persona dhe u plagosen 382 të tjerë. Në Dajç, në një familje vdiqën pesë veta.

Për përballimin e situatës u ngrit Shtabi Qendror i Republikës dhe shtabet e rretheve. Gjithashtu u mobilizuan me mijëra forca nga ushtria, rendi dhe vullnetare për tu gjendur sa më pranë në ndihmë të njerëzve në nevojë. Familjeve pa strehë iu dhanë çadra, batanija, ushqime, veshmbathje etj. Motoja e ditës: "Të shpëtojmë sa më shumë jetë njerëzore". "Të gjithë për një dhe një për të gjithë."

Edhe Drejtoria PTT Shkodër u godit rëndë nga tërmeti. Ai shkatërroi pjesën më të madhe të linjave dhe godinave, veçanërisht në zonën e NënShkodrës e më gjërë. Intensiteti i lartë i punimeve për eliminimin në kohë rekord të pasojave të tërmetit apokaliptik kërkonte mobilizimin total, investime suplementare, rritjen e mëtejshme të sasisë e cilësisë së shërbimeve postare, telefonike e telegrafike, sepse njerëzit e aksionit që ishin me mijëra kishin nevojë urgjente të komunikonin çdo ditë me familjen dhe të afërmit e tyre. Si Kryetar i Deges së Finances i asaj periudhe të lavdishme, e cila nuk mund dhe s' duhet të harrohet kurrë, falenderoj nga zemra, përsëri edhe tani pas 39 vitëve, të gjithë punonjësit e PTT Shkodër, veçanërisht ata të shërbimit, teknikët e fillrojtësit, të cilët punuan ditë e natë me përkushtim e sakrificë për zbatimin në mënyrë korekte të detyrave të ngarkuara.

Filluan të "lulëzojnë" një nga një për tu bërë shumë si lulet që çelin në pranverë shtëpitë e reja, të cilat u dhanë falas të gjithëve pa përjashtim nga shteti. Në këtë kuadër u rindërtua plotësisht nga themelet lagjja e vjetër e Bohçallekut, e cila krahas bujarisë e fisnikërisë së banorëve të saj është e njohur edhe për kopshtet plot me pemë frutore. Një qytet i vogël modern me vila dykatëshe shkëlqente si margaritar, sidomos natën, në hyrje të qytetit.

Termetët kanë origjinë, forcë shkatruese e karakteristika të veçanta në krahina e zona të ndryshme të

planetit. Ata u përkasin atyreve fenomenëve madhore, të cilët megjithëse kanë një "regullator", veprojnë jashtë dëshirës, vullnetit e kontrollit të çdo force tjetër. Njerëzimi, me zhvillimin e mëtejshëm të Shkencës e Teknikës, po futet gjithnjë e më thellë në zbulimin e "mekanizmit misterioz" të termetëve duke krijuar mjete dhe paisje çdo herë e më moderne për "parashikimin" sa më të saktë të kohës e forcës goditëse të tyre. Planifikimi i "masave parandaluese", veçanërisht projektimi e ndërtimi i të gjitha godinave më cilësi, bazamente e konstruksione të studiuara e solide është përgjegjësi sëpari e Shtetit, e specialistëve dhe e çdo qytetari. Çdo nënvlerësim, anashkalim, indiferentizem, shkelje ose abuzim do të kishte pasojë fatale për vendin, njerëzit e shoqërinë.

Nën kambët tona po çahet toka

Me Diell plot shkelqim erdhi dita e 15 Prillit
Përbindshat e nëntokës i zuri terbimi
U tunden male e kodra, "Rozullimi"
Në Shkodër e Lezhë shpërtheu mjerimi!

Në mes të germadhave dikush thirri:
O Zot! Ç'na gjeti! U përmbys Bota!
Një tjetër erdhi dita e Kiametit!
Nën kambët tona po çahet toka!

Frikë, tmerr, lëkundjet e tokës vazhdojnë!
Në oborre, kopshte, rrugë e trotuare
Me rrobat e natës, përjashta qëndrojnë?!
Sirenat e ndihmës së shpejtë sinjalizojnë vaje!

Shqipëria si një repart ushtarak u ngrit në kambë:
"Të rindërtojmë shpejt dhe me çdo çmim vendin
Njerëzit tonë në asnjë rrethanë s'mund t'i lajmë
Pa shtëpi, ngrohje, në mes skamjes, urisë e territ."

E Diel, Ringjallja e Jezusit, festa e Pashkëve
Një urdhër nga Lartë: "Të gjithë në aksion
Puna vullnetare, leitmotiv i proletarëve
Jemi në rrethim, o burra kush është trim!"

dhe Hardhuca e zakonshme); pa gjymtyrë (Gjarpri i ujit, i gardhit, Rrëshaja e Nepërka apo Skrapthi).

- Shpendët këtu janë shtegtarë dhe të përherëshëm. Shtegtarë: Dallëndyshja, Lejleku, Pata e Egër, Rosa e Egër; të përherëshëm: Skifterët, Sorra, Laraska, Harabeli, Trumcaku, Qyqja, Kukuvajka.

- Gjitarët: Grabitqarë (mishngrënës) janë Ujku, Dhelpra, Nusja e Lalës (Bukla), Lundërza (në ujë); Barngrënës: Lepuri i egër, Iriqi dhe Miu.

Në vend të mbylljes: një Falënderim!

Nuk ka gjë më bukur besoj, që në mbyllje të kësaj përmbledhjeje të dhënash mbi Krahinën e Zadrimës, të citoj një tekst biblik, që është një Himn i mrekullueshëm falënderimi ndaj Krijuesit të Gjithësisë. Është ftesa që të gjitha krijesat e Zotit ta falënderojnë Zotin:

"I bekuar je, o Zot, Hyji i etërve tanë, i lavdishëm e tejet i lartësishëm në shekuj! I bekuar emri shenjt i lavdisë sate...

I bekuar je, ti që shqyrton humnerat e që rri mbi kerubinë, i lavdishëm e tejet i madhërueshëm në shekuj! I bekuar je në kupën qiellore, i lavdishëm e i madhërueshëm në shekuj! Bekojeni, të gjitha veprat e Zotit, Zotin, lëvdojeni dhe madhërojeni në shekuj! Bekojeni, o qiej, Zotin, lëvdojeni dhe madhërojeni në shekuj! Bekojeni, engjëjt e Zotit, Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Ujëra që jeni përmbi qiell, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Të gjitha ju, o fuqi, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Diell e hënë, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Yjet e qiellit, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Të gjitha shirat e vesa, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Të gjitha ju, o erëra, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Zjarr e vapë, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Acar e vapë, bekojeni Zotin, lëvdojeni e bekojeni në shekuj! Vesë e brymë, bekojeni Zotin, lëvdojeni e

madhërojeni në shekuj! Akull e cegëm, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Breshri e bora, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Net e ditë, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Dritë e errësirë, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Vetëtimia e re, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Toka e bekoftë Zotin, e lëvdofitë dhe e madhëroftë në shekuj! Bekojeni, o male e kodra, Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Bekojeni Zotin, të gjitha bimësitë e tokës, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Dete e lumenj, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Bekojeni, burime, Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Përbindësh e gjithçka lëviz në ujëra, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Të gjithë shpendët e qiellit, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Kafshë të egra e shtëpiake, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Bijtë e njeriut, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj!

Bekoje, o Izrael, Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Priftërinjtë e Zotit, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Shërbëtorët e Zotit, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Shpirtra e frymë të të drejtëve, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Shenjtër e të përveuajtur në zemër, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Anani, Azari, Misael, bekojeni Zotin, lëvdojeni e madhërojeni në shekuj! Sepse Ai na shpëtoi nga Nëntoka, na nxori nga pushteti i vdekjes, na liroi nga furra e skuqur, na shpëtoi nga mesi i flakëve! Falënderojeni Zotin, sepse është i mirë, sepse e amshueshme është dashuria e tij! Të gjithë ju që e druani Zotin, bekojeni Hyjin e hyjnive, lëvdojeni e falënderojeni, sepse e amshueshme është dashuria e tij". (Danieli 3, 52. 55-90).

Nikolin Sh. Lëmezhi

Kanga IV

Ata që nuk mëkatuen, por që ishin të papëgzëuem. Ndahen qartësisht në dy grupe: grupi i parë qëndron në errësinë, asgjë nuk shquhet aty, nuk dëgjohet gjë tjetër veç psherëtimëve; grupi i dytë, që përbahet nga personalitete të shqueme të njerëzimit, gjithashtu të papagëzëuem, qëndron në një vend të ndriçuem nga një zjarr dhe në oborrin e një kështjelle të rrethuese me shtatë radhë muresh dhe nga një vijë uji.

Koha: *E premija e shejtë, 8 prill 1300.*
 Vendi: *Limbi, Rrethi i parë i Ferrit.*
 Personazhet: *Dante, Virgjili.*

Ma nxori gjumin, q' aq më kish mbërthye,
 një gjamë vetime e fort më ka tronditë,
 3 *sa, krejt i trembun, n'kambë mejherë kam kcyë; 1*
dhe synë e çlodhun rreth e kam vërtitë,
me ngulm, tu' u rrekë që me shikim të çaj,
 6 *për t'njohun vendin ku më kishin qitë. 2*
E vreja at'herë se paçë arritë në majë
të grykës s'atij hon plot me vajtim,
 9 *q' ushtimën mbledh t'pafundmeve travajë. 3*

1 *Ma nxori gjumin* - Kanga zen fill drejtpërdrejt nga mbyllja e të paraardhunës; ajo kataklizëm e natyrës në Ferr, me tërmetin dhe vetimën ngjyrëkuqe, ka ba që Dante të humbë ndjenjat. E sjell në vete një tjetër ndodhi e kësaj natyre, simbol i dhunës dhe i pëshptjellimit. Nga ana tjetër, në hapjen e tercinës dhe të kangës, folja (në origjinal: *rupemi*), përdorë për të tregue daljen e befite nga gjumi, ngjan me një thyemje të vërtetë, çka pasqyron ndryshimin e ambientit dhe gjendjen shpirtënore të protagonistit. Vërejmë se lidhja e dy kangëve të njëpasnjëshme përmes një fjale, përdorë në vargun e fundit të njenës dhe në vargun e parë të tjetrës (*gjumi*), do të jetë një kostante e ndjekun shpesh nga Dante.

q' aq më kish mbërthye - "Në këto katër tercina, që përbajnë pjesën e parë të kangës, autori na tregon se si asht zgjue nga gjumi, që e ka zanë kur gjamoj qielli, siç asht përshtkruer ma sipër. E me t'u zgjue sheh se gjendet në bregun tjetër të Akerontit. Por se si ka shkue aty, nuk na e thotë. Ketë ne duhet ta marrim me mend: ajo vetimë asht shkaktue nga ardhja e Engjëllit [edhe ma vonë Engjëlli i vjen në ndihmë Dantes, shoquene me fenomene natyrore spektakolare (K.IX, v.64-72)], i cili, si këtë e ka zanë gjumi, e kap dhe e nxjerr andej. Këtë nuk na e thotë, përisht sepse e ka zanë gjumi dhe nuk asht i vetëdijshëm: sepse ai që ften, nuk ndjen [...] meqenëse gjumi fillon në krye e mandej zbrret në të gjitha gjymtyrë e trupit: kur njeriu ften, pushon së qeni aktive gjithë ndjeshmënia e tij, ajo çka nuk pushon, asht natyra vegetive e njeriut. Për këtë arsye, se ndjeshmënia qëndron në krye, aty ku asht ndërpre, aty rifillon; aty ku ka fillue gjumi, aty ndërpritet" (Buti, f.115).

një gjamë vetime - Disa komentues, si Buti e Benvenuti gjejnë tek kjo vetimë atë që përshkruen Dante ma hollësisht në v.9, pra gjamët e ankimet e të dënuemve të Ferrit në përgjithësi e jo veç të Rrethit I. Kështu, simbas tyne, Dante asht zgjue nga thirrjet pa ngushëllim që vijjnë nga honi i Ferrit e që, të gjitha grupue në një za, vijjnë në veshët e tij në formën e një gjame shakulluese pa ndërpre. Komentues të mavonshëm mendojnë se, përkundrazi, bahet fjalë thjesht për gjamë vetime, tue pa befasinë dhe intesitetin e kësaj zhurme.

Për të qenë të saktë, duhet të kujtojmë se Dante rrefen *ndodhinë ma të randësishme të jetës së tij* në mënyrë alegorike dhe, raste të tilla, në mënyrë metaforike. Duke u nisë nga kjo, mund të themi se komentuesit e vjetër kanë të drejtë: ajo *gjamë vetime* që Dante ka dëgjue, nuk duhet të jetë tjetër, por thirrjet e të gjithë të dënuemve të Ferrit. Ai gjendet në buzë të honit të Ferrit (në fakt aty *dikush* e ka sjellë) dhe, në atë çast që aty asht lanë, ka dëgjue vajtimet, ankimet, thirrjet, ulërimat e të dënuemve të të gjithë rrahëve të Ferrit, të cilat, tue u dëgjue befasishtëm (sapo lanë aty - shih komentin e Butit, ma sipër) në atë prag, i vijjnë si të ishte një vetimë shungulluese (çka e ka ba edhe me u përmëndë). Po të mos ishte shprehë poeti në mënyrë metaforike, do të thonim se kemi të bajmë në një fenomen natyror. Por, nëse do të ishte kështu, si ka mundësi vallë të kemi në Ferri të tilla fenomene atmosferike, kur poeti na e thekson shumë herë përgjatë këtij kantiku se ajri i Ferrit asht i randë (i palëvizshëm, përvçesë në rrethin e dytë, çka nevojitet për të torturue *epshorët*). A nuk do të përbande kjo një kundërshti? Duke marrë shkas nga kjo pamundësi, mendojmë se nuk kemi të bajmë me agjentë atmosferikë, ma konkretisht *gjamim vetime*, por thirrjen e bashkueme të të gjithë të dënuemve, që, nga pragu i honit të Ferrit, duket si i tillë, pikërisht siç mendojnë komentuesit e vjetër, përmëndë ma nalt.

n'kambë mejherë kam kcyë - Bahet fjalë për një zgjim nga gjumi, apo ardhje në vete në mënyrë jo të natyrshme. Sapo asht lanë aty nga Engjëlli (simbas Butit), ka dëgjue zhurme shakulluese, e cila e ka sjellë në vete, për shkak të befasisë së saj. Në çast ka brofë në kambë si i trembun.

2 *synë e çlodhun* - Sytë e Dantes patën humbë shikimin nga ajo dritë e kuqe, përshkrue në fundin e Kangës III, çka ka sjellë të fiktin, apo gjumin. Mbas një pushimi të shkurtë, duken të çlodhun

tu' u rrekë që me shikim të çaj - Fillon këtu sforcimi i vazhdueshëm me shikue në atë terr thejse të plotë, çka do ta shoqnojë poetin në të gjithë udhëtimin e tij në Përtej.

ku më kishin qitë - Dante nuk na thotë asgjë se si ka kalue Akerontin. Dhe nuk ka se si: për shkak të një vetime të gjamshe, i ka ranë të fikët (a e ka zanë gjumi). Krejt ndryshe nga herët e tjera, siç ban kur thotë se ka hypë në varkën e Flegjasit apo shpinën e Gerionit. Por, përderisa na thotë se asht gjendë në anë tjetër, disi e ka kalue Akerontin. Por, këtë vetim mund ta marrim me mend. Për të dhanë një shpjegim hamendësor, na mjafton fantazia e Butit, i cili na sugjeron se ka qenë Engjëlli qiellor, i cili ka ndërhy në mënyrë spektakulare, të cilin do ta shohim edhe një herë tjetër të ndërhyjë kështu në këtë kantik.

3 *E vreja at'herë...* - Në origjinal: *vero e' che...* Kjo shprehje gjendet shpesh e përdorun në *Komedj*, zakonisht me vlerë përforcuese për vërtetësinë e një fakti, apo edhe në kuptimin leJOR, pra kur edhe se ngjan si jo e vërtetë, asht e tillë. Në këtë rast, ngjan t'i përgjigjet një fenomeni që nënkuptohet: *Se çfarë ka ndodhë, e se si e kam kalue Akerontin, nuk e di. Ajo çfarë di asht se jam gjetë...* Për këtë arsye, në përthimin tonë, meqenëse kontekstit ma përshtat i shkon, e kemi sjellë në formën e *vreja at'herë se...*

në majë - Për ndryshe, në prag, në hymje, në kufi.

të grykës s'atij hon - Ka raste në *Komedj* që Ferri perifrazohet qoftë me *luginë*, qoftë me *hon* (greminë), pra ngjan se edhe në këtë rast, *luginë* e *hon* janë sinonime. Në përfytyrimin e Dantes Ferri asht një hon i thellë dhe fort i pjerrët, që shkon deri në qendër të Tokës, ku ndodhet Luciferi. Këtu sapo asht përmëndë Ferri, vaget e joqartë, sepse poeti ndjek fillin e fabulës, ku ai edne nuk asht i informuem saktë për formën dhe strukturën e tij. Ma vonë, në

I errtë, i thellë dhe plot me mjegullim,

sa edhe se syni ngulë qe n'thellësi,

12 *asgja prej terri s'bante ndoj dallim. 4*

«Në t'verbtën botë do zbresim ne tashti»,

- poeti m' tha tue marrë njëfarë zbardhimi. -

15 «Qëndro mbas meje e unë kam me të pri». 5

Por, kur në sy më ra i zbehtë ngjyrimi,

i thashë: «Si t'vij, kur gjaku të ka ikë,

18 ty vetë, që m'je fashitje e çdo dyshimi?». 6

«Ai ankthi i gjindes», - gjegj i vjetri mik, -

«që ndodhet ktu, fytyrën ma ngjyros

me atë mëshirë që ty po t'duket frikë. 7

Por, t'ecim, rrugë të gjatë do kem me sosë».

Gjë tjetër s' tha, po u nis e m'pat drejtue

në rreth të parë, që honin e qarkos. 8

Kangën XI, përmes Virgjilit, ai do të ketë një pamje të detajueme. Kështu, ajo çfatë përcepton Dante në këtë pikë të udhëtimit të tij, asht e pjesshme e, çfarë vëren, asht thjesht një hon që paraprihet nga çfarë me një luginë ngjason.

ushtimën - Në origjinal: *'ntrono*, formë e apostrofueme, paskajorja e të cilës ka formën *intronare*. Meqenëse fjala, për shkak të metrikës, asht apostrofue, dhe për këtë përngjasue shumë me *tronare* (v.2), ka ba të mundun dy interpretime të ndryshme: nga disa komentues ajo merret si *introno/intronare* apo *intruonare* (përdorë gjithashtu në K.VI, v.32, dhe XVII, v.71) në kuptimin *ushton, shungullon*, dhe *truono/tronare* apo *truonare, gjamim (vetime)*. Nëse poeti ka shkurtue fjalën *introno*, pra *ushëtimë* apo *shungëllimë*, na del se ai në këtë çast dëgjon një zhurme të vazhdueshme, çka korrespondon me vajtimin e pafundëm dhe të pandërpremtë të të munduemve që vujenë në Ferr. Nëse do të mendonim se bahet fjalë për *truono* (gjamim) na del se çfarë ndjen në këtë çast asht thjeshtë një gjamim vetime, i ngjashëm me të masipërmin (v.2). Por, tue pasë parasysh se kjo zhurme ka lidhje me t'*pafundmet travajë*, me diçka që nuk ka fund në përjetësi, mendojmë se asht apostrofue fjala *introno*, pra *ushëtimë*, apo *shungëllimë* që asht e pafundme e që mbush terrinën e Ferrit, çka edhe kemi reflektue në përthim.

mbledh - Bashkon zanat që vijjnë nga vende të ndryshme të Ferrit në një za të vetëm e, tue qenë se ky ankim, këto travajë, janë të vazhdueshme e të përjetshme, ky za ushton, shungëllon pafundësisht. Një fenomen i tillë ndodh edhe në Parajsë (Parajsja XIV, v.122), me adhurimet e të bekuemve, të cilat, tue u mbledhë bashkë, përbajnë një *muzikë* të vetme.

t'pafundmeve travajë - Bahet fjalë për vuetje e Ferrit në përgjithësi, e jo të Rrethit I, përndryshe do të ishte një kontradiktë me vargjet 25-27, ku rrëfehët se në Limb nuk ka ankime apo vajtime shkaktue nga mundimet, por veç psherëtimja theujse të pazashme, përmes të cilave *limbetarët* shfaqin palumtuninë e tyne ngaqë nuk janë në prani të Perëndisë, edhe se *pa faj*. Vazhdun seria e mbiemrave *pafundësisht, i përjetshëm, i verbët*, etj., me vlerë hiperbolike, të përdoruna kryesisht në kangët e para, me anë të të cilëve poeti ngulmon në natyrën e tmerrshme të Ferrit.

4 **I errtë...** - Tre cilësimet (*i errët, i thellë, plot mjegullim*) përshkruajnë si zbulohet para Dantes honi i Ferrit përgjithësisht. Ato vijjnë varg tue plotësue njeni-tjetrin, për të përcjellë tek lexuesi çfarë ka ndie Dante personazh me t'u gjendë aty: ankth dhe frikë. Do të kishte mjaftue me thanë *i errët*, por aq ma tepër ridimensionon negativisht përfytyrimin e Ferrit përcaktori *i thellë...* Çfarë sheh ai asht theujse kurrigja, sepse *prej territ, asgja nuk bante dallim*. Si duket, ushëtima shungulluese e zanave që vijjnë prej poshtë honit, i jep me kuptue atij thellësinë, çka tridimensionon, jo vetëm mjedisin në të cilin gjendet, por edhe ankthin. Cilësimi i tretë, ashtu si i dyti, i papërceptueshëm përmes shqisë së të pamit (indirek, mbase përmes nuhatjes), plotëson informacionin që na lejon me kuptue se në ç'mjedis gjendet.

plot me mjegullim - Përngjashmëni situatë biblike: *"Dhe ai hapi pusin e humnerës dhe nga pusi u ngrit një tym si nga një oxhak i madh; dhe dielli dhe ajri u errën nga tymi i pusit"* (Zbulesa 9:2).

dhe se syni ngulë qe - Folja *ngulë* përdoret për të tregue se një send i fortë e me majë asht futë me turr (vështirësisht) në një tjetër send të rrastë, të dendun. Në këtë rast kjo folje, përdorë për sytë, jep idenë se, jo vetëm vendi asht në një errësinë të madhe (edhe se jo të plotë), por gjithashtu zhytun në një mjegullim të thellë, çka shërben si një përforcim i vargut të masipërm, përmes të cilin na përshkruhet në vija të trasha Ferri.

5 **Në t'verbtën botë do zbresim ne tashti** - Virgjili e merr fjalën në mënyrë solemne, por gjithashtu tue transmetue keqardhje të thellë. Ai po hyr në atë botë dhimbjesh (që asht gjithashtu bota e vet), privue nga drita materiale dhe morale. Në këtë kangë Virgjili asht protagonist i vërtetë, si figurë qëndrore e botës antike parakristiane, të cilës këtu i këndohet madhëshitia, por gjithashtu mangësia.

t'verbtën - Ky mbiemër, që asht tipik për Ferrin, përdorë me kuptim thellësisht moral, këtu ka një vlerë të veçantë, sepse asht pikërisht kjo çfarë karakterizon Limbin, apo *Rrethin* e *Virgjilit*, ku asgja tjetër nuk mungon, përvçë dritës së besimit. Kujtojmë se Limbi, simbas poetit, asht vendi ku vuejnë mungesën e dritës së Perëndisë të gjithë ata njerëz të drejtë që nuk arritën të njohin besimin e krishtenë, apo të gjitha ata fëmijë të porsalindun, që vdiqën pa u pagëzue.

Qëndro mbas meje e unë kam me të pri - Komentues të ndyshëm përzgjedhin ta interpretonin këtë varg nën dritën e kuptimit alegorik, si për shembull: 1. Arsyja [Virgjili] duhet të drejtojë ndjeshmënjë [Danten], sepse ajo është superiore (Landini); 2. Dante duhet të *ndjekë* Virgjilin, sepse, shumë çka Dante përshkruen, janë thanë ma parë të *Eneida* (Benvenuti). Por mendojmë se shpjegimin ma të thjeshtë e ma të drejtë e ka dhanë Bokaço (f.135): *"Në këtë mënyrë Virgjili përpikat t'i krijojë siguri gjatë ecjes, sepse ai që ec përpara, ndesh i pari vështirësitë dhe i mënjanon, tue ba që ai që ndjek, ta ketë rrugën ma të lehtë. Kështu ban një udhërrëfjes i mirë"*.

6 **Por, ...** - Dante, zbardhimin e Virgjilit, e merr si një frikë që ky ka ndaj ushëtimave që dalin gjamshein nga gryka e honit të Ferrit. Për këtë arsye, edhe ai ndihet i humbun dhe i privuem nga sigurija që duhet t'i japë atij mjeshtri.

m'je fashitje e çdo dyshimi - Virgjili ka qenë deri tashti ndihmë në të gjitha vështirësitë e Dantes (kujtojmë K.I, v.91; K.III, v.14-15). Kështu, nëse ai frigohet, që asht drejtuesi, pika e referimit, si mund të trimohet ai që e ndjek?! Ky varg asht shembulli i parë i asaj natyrshmënie e gjallnie dialogu familjar që për Komedinë përban një rrobë të pazhveshëshme asnjëherë dhe asht një prej elementeve kryesore të vërtetësisë që e karakterizon atë.

7 **Ai ankthi... ty po t'duket frikë** - Virgjili zgjidh keqkuptimin e Dantes: zbardhimi nuk i vjen nga frika, por nga turbullimi që i shkakton të afruemit në Limb, që asht edhe vendbanimi i tij, si dhe i poetëve e i dijetarëve të tjerë, me të cilët ndan *psherëitë*. Kështu e interpretojnë pjesa ma e madhe e komentuesve.

8 **t'ecim...** - Përvçesë udhëtarët e kanë vërtetë kohën e pakët e shpesh janë të detyruem të nguten, në këtë rast duket sikur Virgjili kërkon ta mbyllë shumë shpejt fjalën, për shkak se gatiten të hyjnë në vendin e vuetjes së tij, çka e trazon pafund. Në këtë pasazh na përfigurohet shpirti i Virgjilit, sa i thellë në ndjenja, aq i rrezervuem t'i shfaqë ato.

Këtu, sa ç'mundte veshi me dëgjue,

nuk kishte vāj, por se prej psherëtive

27 dridhohej ajri, sa nuk kish t'mbarue; 9

jo plagësh ishte shkaku i mundive

për këto turma, t'shumta e të mëdha,

30 të burrave, të grave e të fëmive. 10

Mësuesi mue: «Përse s'më pyet ti mâ,

se ç'shpirtna janë këta që po shikon?»

33 Ta dish, përpara se përtej me bâ, 11

që ata s'kanë mëkatue; por nuk mjafton

me pasë merita: t'pagëzëuem nuk qenë,

36 çka asht një kusht për fenë që ti beson; 12

në rreth të parë ... - Perifrazim për Limbin, që Dante, ashtu siç e don tradita, e ka vendosë në pjesën ma të naltë të Ferrit. *Limb* vjen nga *lemb*, që do të thotë *skaj, cep, majë* e, në rastin tonë, pikërisht *maja*, *vendi ma i naltë* i Ferrit. Kjo kupton se banorët e tij, në mos të pafajshëm, janë ma pak të fajshkimit në bashkësinë e mëkatarëve. Limbi asht vend i privuem nga gëzimi, por ku gjithashtu mungojnë vuetjet fizike dhe torturat. Simbas doktrinës katolike, në Limb nuk ndëshkohet një mëkat i kryem nga individi, por ai vuen mëkatin origjinar, që nuk asht shlye e pastrue me pagëzim dhe dënimi asht ekzistencia në mungesë të pranisë së Perëndisë, pra ma i lehti në Ferr. Në ndryshim nga modelet e maparshme (ai katolik, i sugjeruar nga Tomas D'Akuini, që asht vend për patriarkët e Iyraelit dhe fëmijët e papagëzëuem - shih shënimin 10), Limbi i Dantes asht gjithësi origjinal, një vend i veçantë, ku mungojnë torturat, por gjithësi nuk asht Parajsë. Kjo veçanësi i ka shërbye atij me vendosë aty herojtë e botës antike, njerëzit e drejtë, që nuk kanë njohë besimin e krishtenë.

Rrethi i parë - Ferri asht imagjinue nga poeti si një kon me majë poshtë, i cili asht i shkallëzue nanntë herë, simbas nantë mëkateve kryesore. Qëllon që rrahët të jenë një njësi e vetme, si Limbi, apo si të gjithë rrahët e pjesës së sipërme të Ferrit, deri në muret e Dites. Mbas këtyne mureve, që quhet pjesa e poshtme e Ferrit, qëllon që rrahët të jenë të ndamë në nënrrathë e, simbas rasteve, quhen *qarkë, sektorë, lujge dhe zona*. Për strukturën e Ferrit do të flasim ma hollësisht në Kangën XI, tema e të cilës asht pikërisht kjo: shpjegimi i strukturës së Ferrit nga ana e Virgjilit.

9 **sa ç'mundte veshi me dëgjue** - *Simbas asaj që mundej me u kuptue përmes dëgjimit*, meqenëse përmes shikimit ishte e pamundun... Me këtë tercinë hymjëm vërtetë në Rrethin I që, nga sa dëgjohet, ngjan me një kor të madh psherëtimash. Çfarë të ban përshtypje në këtë kangë e të prek gjithashtu, asht pikërisht kjo psherëtimë e pafundme e shpirtnavë të atyne që janë pezull, drejtue kah qielli si një lutje ankuese dhe e dëshpërueme, pa shpresë përmbushjeje.

dridhohej ajri - Perifrazim tepër i tërthortë për të përshkrue ambientin e Ferrit. Na asht thanë edhe ma parë (kujto K.I, v.114 dhe K.III, v.8) se ai asht i përjetshëm. Nga kjo psherëtimë e pashpresë dhe e dëshpërueme, çka pasqyron gjendjen e randë dhe vuetjen e thellë të limbetarëve, edhe se asnjë mundim fizik nuk ushtrohet mbi ta, trand përjetësisht këtë copë *qielli* infernal. Gjenialiteti i poetit e dërgon vuetjen në ajri, aspak në trollin e Limbit, që bie të jetë trolli i Ferrit, çka e ban dramatikë gjendjen e tyne pezull, aq afër shpëtimit, pa qenë të shpëtuem; mjerisht të humbun, pa qenë të munduem.

10 **jo plagësh...** - Banorët e Limbit psherëitjnë, jo për shkak të torturave fizike, por vetëm për shkak të përjashtimit nga mudësia për të qenë në prani të Perëndisë.

për këto turma... - Simbas teologjisë katolike, Limbi asht vendi ku përkohësisht qëndruan patriarkët e Izraelit (*Limbus Sanctorum Patrum*), të cilruem nga Krishti mbas vdekjes, sepse kanë pritë dhe kanë besue në ardhjen e Tij; gjithashtu vendi i përherëshëm i fëmijëve që kanë vdektë të papagëzëuem (*Limbus Puerorum*). Dante (shih shënimin e v.52, Kanga II), jo përshtatshëm me vizionin zyrtar të Kishës për Limbin, vendos aty, tue i shpëtue kështu nga mundimet e Ferrit, edhe paganët që nuk njohën Krishtin (nuk besuan), sepse jetuen para ardhjes së Tij, por gjithësi u ndejnë besnikë virtytue themelore të moralit, megjithëse janë të *njollusun* vetëm me mëkatin origjinar. Ky qëndrim i Dantes nuk kalon pa u vu re e pa u kritikue që nga komentuesit e parë, me të cilin ata distancohen: *"Virgjili thotë këtu se ata që janë në Limb, gjithësi janë të dënuem për mëkatin e mosbesimit [në Krishtin] e jo për tjetër mëkat e këtu banojnë gjithashtu edhe fëmijët e papagëzëuem, si dhe burrat e gratë që kanë ba vepra të mira në jetë e të cilët së paku kanë qenë të vlefshëm, por nuk kanë qenë të krishtenë. Në këtë pikë autori nuk është në një mendje me Kishën e Shejtë, e cila nuk vendos tjetër në këtë vend, veçse fëmijët e papagëzëuem. Le ta justifikojmë poetin, sepse këtë e bën poetikisht... ai mund t'i kishte dërguara [poetët] në Fushat Eliziane"* (Buti, f.120). Për këtë arsye, kemi thanë ma parë se Limbi i Dantes, edhe se i mbështetun në modelin katolik, ka tipare krejt originale dhe të pangatërrueshme.

11 **Përse s'më pyet ti ma** - Këtë rradhë asht Virgjili që ka ngut me i shpjegue Dantes, para se ky t'i drejtojë një pyetje. Gjithë fjala e tij (nga v.31-42) tregon asyen e këtij nguti. Me shpjegue për banorët e Limbit, por Virgjilin do të thotë me folë për vetveten e, me këtë rast, ai don me heqë çdo dyshim nga mendja e dishepullit: *ata s'mkatuen; por nuk mjafton / me pasë merita...* *Për ktë, jo tjetër jemi mëkatarë* ... Mbrojtja që Virgjili i ban vetvetes, vërejmë se asht mbrojtja që Dante u ban të dashtunve poetë, dijetarë e njerëz të tjerë të sheqmet të antikitetit, e gjitha mbështetun në të qenit e tyne të panjollusun me *mëkatin aktual*, por veç me atë origjinar që, simbas doktrinës katolike, shlyhet përmes *pagëzimit* (shih shënimet ma poshtë).

12 **ata s'kanë mëkatue** - Këta paganë (jo të krishtenë) nuk janë ndye me mëkatin aktual. Asht e nevojshme të sqarojmë dy kategoritë e mëkateve të cilat emërton Kisha dhe, gjithashtu, Dante: *mëkati origjinar dhe aktual*.

- **Mëkati origjinar** nuk i referohet tanësisë së mëkateve të kryem nga njeriu, por natyrës apo prirjes së tij mëkatarë, origjina e së cilës asht njeriu i parë, Adami. Sipas doktrinës biblike të mëkati, përmes Adomit, përfaqësuesit të parë të racës njerëzore, mëkati hyni në botë dhe bashkë me të vdekja, si ndëshkim. Këtë e shpreh letra Romakëve 5:12 "...me anë të një njeriu të vetëm [Adamit] mëkati hyri në botë dhe me anë të mëkati vdekja..."; si dhe 5:18-19 "...me anë të shkëljes së njerit [Adamit] erdhi në bbotë gjithë njerëzit dënim... nëpërmjet mosbindjes së një njeriu të vetëm [Adamit] të shumtët u bënë mëkatarë...". Kështu, të gjithë njerëzit lindin dhe vdesin mëkatarë.

Përsa u përket *paganëve që banë një jetë të drejtë*, Bibla thotë se askush nuk asht i drejtë përpara Perëndisë: "... si Judenjtë ashtu edhe Grekët janë të gjithë nën mëkat, siç është shkruar: 'Nuk ka asnjeri që është i drejtë, as edhe një'. Nuk ka asnjeri që të kuptojë, nuk ka asnjeri që të kërkojë Perëndinë. Të gjithë kanë dalë nga udha e tij, që të gjithë janë bërë të padobishëm, nuk ka asnjë që të bëjë të mirën, as edhe një" (Romakëve 3:9-12). Bibla, gjithashtu ven në dukje se paganët do të gjykoohen në bazë të dritës së ndërgjegjjes: *"Në fakt kur johebrenjtë [paganët], që s'kanë ligjin, nga natyra bëjnë punët e ligjit, ata, megjithëse s'kanë ligjin, janë ligj për vetveten; këta tregojnë veprën e ligjit të shkruar në zemrat e tyre për dëshminë që jep ndërgjegjja e tyre, dhe sepse mendimet e tyre shfaqësojnë ose edhe akuzojnë njëri-tjetrin, ditën në të cilën Perëndia do të gjykojë të fshehtat e njerëzve me anë të Jezu Krishtit, sipas*

39 se para Krishtit u qëllloi të jenë,
atë Zot nuk e nderuen siç asht e mbarë:
e pjesë me kta dhe mue më ra të kemë.¹³
Për këtë, jo tjetër, jemi mëkatarë,
42 të humbun dhe me kaq veç të ndëshkuem:
për ç'dëshirojmë, një shpresë pa pasë kurrfarë.¹⁴
M'pikoi mue zemra gjak, me ta dëgjue,
45 se njoha njerëz t'dëjë për çdo vlersim,
që pezull t'rrijnë në Limb janë të gjykuem.¹⁵
«Më thuej imzot, më thuej mësuesi im»,
- kam folë se paçë dëshirë dhe më me ditë,
48 për t'vetmen fë që mposhti çdo dyshim, -¹⁶

ungjillit tim" (Romakëve 2:14-16).

- **Mekati aktual** i referohet tanësisë së mëkateve që kryen njeriu përmes mendimeve, qëndrimeve e veprimeve të cilat i kundërvihen Perëndisë, tjetrit apo vetvetes duke shkelë ligjin e Perëndisë, i cili në thelb përfaqësohet në dhjetë urdhënime. Mekati aktual asht pagzjidhshmënisht i lidhur me mëkatin origjinar, sepse asht shprehje konkrete e praktike e prires së natyrshme njerëzore me mëkatet. Në doktrinën biblike të mëkatisht "të gjithë kanë mëkatuar dhe janë të privuar nga lavdia e Perëndisë" (Rom. 3:23). Këtu Dante nuk i sheh ata si të ndotun nga mëkati aktual, por vetëm nga mëkati origjinar, tue u largue nga doktrina biblike e mëkatisht. Ndoshta sepse sipas Dantes ata, tue mos njohë besimin e vërtetë në Perëndinë, nuk janë të ndërjegjshëm për mëkatin aktual dhe vdiqën në padituni të ligjit të Perëndisë, përmes të cilit identifikohet mëkati.

t'pagëzue nuk qenë - Këtu Dante e ban Virgilin zadhënsin e doktrinës katolike të pagëzimit. Sipas saj, pagëzimi asht sakramend i domosdoshëm për shlyerjen e mëkatisht origjinar e, si rrjedhim, asht dera e shpëtimit. Në praktikën e Besëlidhjes së Re, pagëzimi asht gjithmonë i shoqnuem nga besimi në Krishtin dhe e pason atë: "Ai që beson dhe është pagëzuar, do të jetë i shpëtuar; por ai që nuk ka besuar, do të jetë i dënuar" (Marku 16:16). Pagëzimi asht akti simbolik përmes të cilit shprehët identifikimi me vdekjen dhe ringjalljen e Krishtit për një jetë të re (Rom. 6:3-5). Tue nisë nga shek.V, pagëzimi shihet i lidhur me mëkatin origjinar e, si i tillë, si mjetei efektiv i shlyemjes së tij, jo detyrimisht i lidhur me besimin si parakusht për pagëzimin. Në këtë kontekst futet edhe çështja e fëmijëve të papagëzue, të cilët duke mos pasë të shlyem mëkatin origjinar, pas vdekjes shkojnë në Limb. Edhe kjo çështje asht komplekse për faktin se Besëlidhja e Re nuk përmban asnjë informacion në lidhje me praktikën e pagëzimit të fëmijëve. Si rrjedhim, trajtimi teologjik i këtij argumenti ka kalue nëpër faza zhvillimi të ndryshme në historinë e Kishës. Dante këtu pasqyron doktrinën katolike të kohës në lidhje me çështjen.

13 atë Zot nuk e nderuen - Tue qenë se kanë jatue para ardhjes së Krishtit, nuk kanë adhure Perëndinë në përditë në përditë të zbulimin e Tij. Madje, siç thotë Virgili në Kangën I (v. 72) *n'perëndi t'rremë ish besimi jonë*.

14 Për këtë, jo tjetër - "Shumë prej tyne nuk mëkatuen, përveçse me mëkatin origjinar, por janë aty për shkak se nuk besuen ku duhet" (Benvenuti, f.114). Virgili dhe poetët e dijetarë të tjerë, klasikë e latinë, gjithmonë simbas Dantes, për çfarë nuk kanë ba janë fajtorë.

për ç'dëshirojmë, një shpresë pa pasë kurrfarë - Limbëtarët, edhe se nuk mundohen fizikisht, si të gjithë shpirtat në Ferr, vucjnë mungesën e shpresës. Shpresa, siç kemi pasë rast ta themi edhe herë të tjera, asht të qenit në prani të Perëndisë. Tue u ndi të paplotë, në ndasi me Perëndinë, e tue mos pasë asnjë shpresë që të rikuperojnë këtë defekt (*per difetto di fede, Benvenuti, po aty*), gjendja e tyne asht e dëshpërueme. Kështu, edhe për ata vlen shprehja: *ju që hyni, më mos mbani shpresë* (K.III, v.12). Ky varg i mrekullueshëm përmbyllës që, siç asht në natyrën e Dantes, trok ma së miri dramën ma të madhe të njeriut, qëndron si një flamur, si një epitaf në hymjen e Limbit dantesk. Ai asht i ndërteuem mbi dy fjalë: *dëshirë* dhe *shpresë*, fjalë që janë qëndrore në jetën e njeriut.

15 M'pikoi mue zemra - Dhimbja e madhe shprehë në këtë varg ngjan si jehona që len në shpirtin e Dantens dëshira mbetë pa shpresë (v.42). Përmes këtyne vargjeve (42-43), që janë gjithashtu zemra e kësaj kange, na përçohet e gjithë tragjedia e botës parakristiane, përjashatue nga shpëtimi, siç asht përjashatue përgjithësisht shpëtimi i njeriut përmes forcave (meritave) të veta (*por nuk mjafton me pasë merito* / v.34-35); përmes tyne na përçohet gjithashtu gjurma e pashlyeshme që ky fakt tragjik len tek poeti i krishtenë. Mishnim i këtij përjashatimi dramatik asht figura e Virgilit përgjatë gjithë Komeditë, çka do të manifestohet në shumë raste.

njerëz t'dëjë për çdo vlersim - Fakti që mes tyne ban pjesë Virgili, jep me kuptue se ç'kategori njerëzish aty do të ndeshim. Në ta përqëndrohet gjithë vendimia e Dantes, aq sa qëllimi i kësaj kange duket qartë se asht për të nderue ata.

që pezull t'rrijnë... - Limbëtarët janë PEZULL: *as të ndëshkuem* - kanë ba një jetë të drejtë; *as të shpëtue* - nuk janë të pagëzue, që për një njeri dëshmon se asht i krishtenë.

16 imzot... mësuesi im - Ka gjasa që Dante personazh, tue kuptue landimin e Virgilit, i ofron atij këtë lavdim të dyfishtë, me anë të të cilit përpiqet të jetë ngushëllim për një që sigurisht ka humbë shpresën (asht i pangushëllueshëm), çka e ban atë të përtejtoqë e të tregojë mëshirë.

kam folë... mposhti çdo dyshim - Ende pa e ba, Dante parashtron arsytet e pyetes. Ai kërkon menjëherë të sigurojë lexuesin se kjo pyetje nuk buron nga mosbesimi, as nga dyshimi, por nga dëshira për ta konfirmue besimin. Arsyja pse Dante e parashtron këtë para lexuesit ka të baje me faktin se ajo lidhet me një nga përbamësit e kredos apostolike: *Besoj në Jezus Krishtin që zbriti në ferr* (Credo in Iesum Christum qui descendit ad inferos) e ai nuk don që të keqkuptohet. Ky deklaram i të ashtuqajturës *kredo apostolike* asht adoptue në rëfimin e besimit rreth v. 400 m.K., por ka një traditë ma të hershme. Simbas interpretimit katolik të këtij përbamësi të kredos, në tri ditë, nga vdekja deri në ringjallje, Krishti zbriti në botën e të vdekurve (infernus), ma specifikesht në të ashtuqajturin *Limbus patrum* apo, siç quhej nga hebrejtë, *Gjiri i Abrahamit*, ku ndodheshin patriarkët e Izraelit dhe shpirtat e të drejtëve. Qëllimi i zbritjes ishte shpallja e fitores së tij mbi vdekjen, çlirimi i këtyre shpirtave nga pushteti i saj dhe dërgimi në Parajsë, e cila deri në këtë kohë kishte qenë e mbyllur për njerëzit. Baza biblike e deklaramit asht kryesisht I Pjetrit 3:18-22 (*sepse edhe Krishti ka vuajtur në herë për mëkatet, i drejti për të padrejtët, për të na çuar te Perëndia. U vra në mish, por u ngjall nga Fryma, me anë të së cilës ai shkoi t'u predikojë frymërvare që ishin në burg, që dikur ishin rebelë, kur durimi i Perëndisë i priste në ditë e Noe, ndërsa po ndërtohej arka...)*, por edhe Efesianëve 4:9 (*Tani kjo "Ai [Krishti] u ngjiti". Ç'do të thotë tjetër përveç se ai më parë edhe kishte zbritur në pjesët më të ulta të dheut?*), megjithëse në historinë e Kishës këto tekste janë interpretue në mënyra të ndryshme. Nga njëna anë, Dante pret një përgjigje konfirmuese prej Virgilit, si "*dëshmtar okular*", mbasi ka qenë në Limb kur Krishti ka zbritë; nga ana tjetër, ai po i drejtohet arsyes ma të naltë njerëzore, që Virgili përfaqëson në poemën e Dantes.

«ndokush a duel kënde prej t'tij meritë
a t'tjerakujt, që t'shkojë në lumtuni?».
51 E ai, që shqoi ndër fjalë çfarë qe territë,¹⁷
u gjegj: «Pak kohë si pata ktu mbërrë
një fuqiplotë **pashë** t'vijë ndër këta gjind,
54 me shëjë fitoresh vullë mbi trup të tij.¹⁸
E mor me vete atë të parin prind,
Abelin, t'ijin bir, Noëun profet,
57 Moisiun, atë që mbi të tjerë u bind;¹⁹
Abraamin atë, si dhe Davidin mbret,
krejt Izraelin, atë e bijt grupuem,
60 e me Rakelë, për t'cilën aq u tret,²⁰
e shumë të tjerë i bani të bekuem.
E para tij, ta dish t'vertetën tanë,
63 të tjerë kurrma prej humbjes nuk shpëtuen».²¹

17 ndokush a duel kënde... që t'shkojë në lumtuni - Për faktin se në Limb njerëzit nuk janë të dënuem për mëkatet e tyne, por për shkak të mëkatisht origjinar dhe, gjithashtu, për faktin se jetuen e vdiqën përpara ardhjes së Krishtit, natyrshëm lind pyetja nëse ndokush, *me t'tij meritë a t'tjerakujt*, a ka arritë të shkojë prej Limbit në Parajsë? Në të dy rastet, me *t'tij meritë* dhe me *t'tjerakujt [me ndërhyemjen e...]*, padyshim nënkuptohet Krishti. Në rastin e parë, Dante ka parasysh Krishtin, sepse atij i asht dhanë fuqia, simbas Ungjillit, të fitojë mbi vdekjen. Këtu nuk mund të ketë keqkuptim që me *t'tij meritë* Dante të kuptojë dikë tjetër, pa mëkat, apo që të ketë shpëtue me meritë të vet, sepse kjo do të përbante një absurditet përballë gjithë asaj ç'asht thanë ma sipër: askush nuk mund të shpëttojë nga mundimet e Ferrit. Edhe në rastin e *prej tjerakujt [meritë]*, Dante ka parasysh Krishtin, përmes të cilit shpëtuen gjithë ata që, edhe se jetuen para, besuen në ardhjen dhe shpëtimin përmes Tij. Thanë ndryshe, pyetja e Dantes do të ishte kështu: *A ka qëllue që të vijë Dikush (Krishti) dhe të mund të dalë prej këtu, për t'u vendue në Parajsë dhe, së bashku me Të, ata që në Të besuen?*

ndër fjalë çfarë qe territë - Pyetja e Dantes nuk është thjeshtë e vetëm e natyrshme. Ai beson në kredon apostolike të zbritjes së Krishtit në Ferr, por siç e ka shprehë në v.47-48, kërkon ta konfirmojë besimin e tij nga dëshmia e Virgilit. Ky e kupton që pyetja e Dantes nuk vjen nga padija e as nga dyshimi, por nga dëshira e konfirmimit të besimit.

18 Pak kohë... - Tue ba përpjekje me i shkue fabulës, themi se Virgili kishte 52 vjet në Limb, kur Krishti zbriti për të marrë shpirtat e të drejtëve. Një përllorogarit e thjeshtë: vdiq më 19 pr.Krishtit, shtu 33 moshën e Krishtit dhe do kemi: 19 + 33 = 52. Në raport me përjetësinë, Virgili nuk kishte shumë që ishte në Limb.

një fuqiplotë - "Ky asht Krishti ... i kunorzue mbret dhe me flamurin e kryqit, shenja që duen të thonë se ka triumfue nalt në kryq mbi demonin, amnikun tonë" (Buti, f.122). Krishti shfaq fuqinë e Perëndisë në këtë akt fitoreje mbi Satanin, amnikun e Perëndisë dhe të njerëzve. Siç e kemi theksue edhe ma sipër, për shkak përnderimi, emni i Krishtit nuk përmendet asnjëherë në këtë Kantik.

me shëjë fitoresh vullë mbi trup të tij - Të gjithë komentuesve, meqenëse Dante nuk shpëhet qartë se cilat janë këto shenja, u asht dashtë t'i marrin me mend. Për Butin këto njenja janë *kunora mbretore* dhe *një flamur* në të cilin duket një kryq (ashtu si i templarëve). Përkundrazi, për Anonimin Fiorentin aspak shenjat e fitores nuk janë flamuri a simbole të tjera: "*Nuk shkoi aty me flamur apo shenja të tjera. Fitorja e Krishtit qëndron në faktin se, ashtu si demoni mposhti natyrën njerëzore, ashtu, me natyrë njerëzore Krishti mposhti demonin*" (f.98). Ndërsa A.M.Ch.Leonardi shpëhet: "*J kunorzue me kryq: në ikonografinë mesjetare Krishti shpeshherë asht përfigurue me një aureolë mes të cilës duket një kryq*" (f.94). Gjithashtu ka edhe interpretime të tjera. Për ne do të ishte ma e besueshme që Krishtin të ketë zbritë në Ferr triumfues, ndërsa në dorë ka shejat e gozhdave (stigmat), pasi me këto shenja ai iu paraqit dishepujeve të vet pas ringjalljes, prej të cilave ato u siguruen se ishte pikërisht ai: Krishti i vdekur dhe i ringjallun. "*Pastaj në mbrëmje [...]* *erdhi Jezusi dhe u prezantua në mes tyre dhe u tha "Paqja me ju". Dhe, si i tha këto, u tregoi atyre duart e veta dhe brinjën. Dishepujt pra, kur e panë Zotin, u gëzuan"* (Ungjilli i Gjonit 20:19-20). Këto sheja do të ishin shejat e sigurisë së kësaj fitoreje për të krishtenët.

19 atë të parin prind - Adami asht njeriu i parë e, për rrjedhojë, meqë prej tij rrjedh gjithë gjinia njerëzore, gjithashtu edhe i pari prind. Këtu fillon lista e Etënve, marrë nga Limbi prej Krishtit mbas vdekjes së tij.

Abelin, t'ijin bir - Abeli, bir i Adamit, vra nga vëllai i tij, Kaini (Zanafilla 4:1-16).

Noeun - Qe shpëtue me familjen e tij nga përmbytja e përgjithshme, me anë të arkës, ku qëndroi për 40 ditë. Me të Perëndia bani një marrëveshje (Zanafilla 6:8).

Moisiun... - Moisiu, mrekullisht shpëtoi popullin e tij nga përndjekja e Faraonit të Egjiptit, përndjekje që synonte të pengonte daljen e tyne nga skllavëria në Egjipt. Ndërsa udhëtonin drejt Tokës së Premtueme, mori nga Perëndia Ligjin dhe ia dha popullit për zbatim, që përmban një seri kushtesh për rregullimin e jetës personale, familjare e komunitare (Eksodi 21 e vazhdim; Ligji i përtëritur, 10 e vazhdim).

20 Abraamin atë - Fillimisht quejtë Abram (Atë i Naltësue) mandej Abraham (Atë i Popujve), banor i Urit në Kaldea. Për shkak të bindjes ndaj Perëndisë u konsiderue i drejtë në sytë e Tij. U zgjodh të ishte fillimi i popullit të zgjedhun të Perëndisë. Kaq i bindun qe, sa ishte i gatshëm të flijonte të birin, Izakun, në altat kur kjo i kërkohet (Zanafilla, 13 e vazhdim).

Davidin mbret - Mbret i Izraelit rreth vitit 1000 pr.K. Besimi, ndërmarret në beteja kundër anmiqve të Izraelit, dobësitë njerëzore dhe gabimet e tij janë rrëfyne në Librin II të Samuelit. Qe autor i shumë psalmeve.

Izraelin - Emri i dytë i Jakobit, birit të Izakut. Nga dymbëdhjetë bijtë e tij rrohdën dymbëdhjetë fiset e popullit që u quejt me këtë emën: Izrael. Jakobi u mbiquejt *Izrael*, që do të thotë *ai që lufton me Perëndinë* (Zanafilla, 32:29) mbasi, për të fitue bekimin e Perëndisë, nuk u tremb të luftonte me një engjëll që Perëndia i kishte dërgue.

me atë - Ati i Jakobit (Izraelit) ishte Izaku, biri i Abrahamit.
bij - Dymbëdhjetë bijtë e Jakobit, që do të ishin baza e formimit të popullit Izraelit.

me Rakelë... për t'cilën aq u tret - Rakela, gruaja e Jakobit. Për t'u martue me të, atij i desh t'i shërbente atit të saj (Labanit) për shtatë vjet. Mbas një mashtrimi të randë që i bani vjehri i tij i ardhshëm, u detyrue të marrë fillimisht për grue të motrën e Rakelës, Lean (jo e bukur dhe e madhe në moshë), vetëm mbas shtatë viteve të tjera shërbimi e pune të randë në shtëpinë e Labanit, Jakobi martohet me Rakelën (Zanafilla, 29:16-30). Kështu, atij iu deshën katërmbëdhjetë vjet punë e randë dhe rraskapitëse për të marrë Rakelën për grue, mbas të cilës ishte marrëzisht i dashnuem. Ndaj Dante thotë *për t'cilën aq u tret*, pra dërmue nga puna e randë, dobëse fizikisht.

21 E para tij - Para ardhjes së Krishtit në Ferr, para vdekjes së Tij. Konfirmohet kështu që çlirimi i shpirtave të të drejtëve (për besim) nga Limbi ka ndodhë vetëm me zbritjen e Tij.

Ndërsa po fliste, ecjen s'patëm lanë,
dhe i pyll përshkonim lehtas tue marrë hark,
66 një pyll të dendun shpirtnash, jam tue thanë.²²
Endë me t'ecun s'patëm shkue shumë larg,
69 prej ku m'duel gjumi, kur një zjarr kam pa,
që kishte thye terrinë rretheqark.²³
Atje që t'shkonim duhej dhe paksa,
por jo sa t'mos dalloj se pjesërisht,
72 për njerëz t'shquem ky vend të ishte nda.²⁴
«O ti që dije e art nalton thellsisht,
këta kush janë, që kaq e fort nderohen,
75 e që prej tjerësh ndahen qartësisht?»²⁵
Ai mue: «Për lavde emnat u lakohen
në t'tanden botë, ku prap ti ke me u kthye,
78 në qiell gjejmë hir, ndaj ktu privilegjuohen».²⁶
N'atë çast do zâne heshtjen e kanë thye:
«Ta përnderoni këtë të naltë poet;
81 për pak largue prej nesh dhe prap rikthye».²⁷
Mandej, kur zani heshtjen krejt e gjet,
nja katër hije t'mdhā u ndalën pranë:
84 trishtit as shend nuk kishin n'fytirë të vet.²⁸

ta dish t'vertetën tanë - Një afirmim i tillë kaq i vendosun i Virgilit buron nga v.48, në të cilin Dante, jo për dyshim mirëfilli, por për sigurim, ka ba pyetjen të cilës Virgili i shpjegohet gjatë.

22 pyll të dendun shpirtnash - Metaforë me anë të së cilës poeti ngul kambë në numrin e madh të shpirtave në Limb.

23 Ende ... larg - Me anë të këtij vargu na jepet një tregues kohor dhe vendor: Nuk kish kalue shumë e, kështu, nuk kishin ba shumë rrugë, nga vendi ku atij i kish dalë gjumi prej gëmbës.

prej ku m'duel gjumi - Në origjinal: *di qua dal sonno*. Disa komentues fjalën *sonno* e marrin *sonno*, tue pasë parasysh kaligrafinë (shkrimin me dorë), ku asht lehtë që n e dyfishtë të merret për m. Në këtë rast, pra nëse do të marrim *sonno*, atëherë do të kishin *nga maja e gropës*, pra *në prag të Rrethit I*. Meqenëse, qoftë *sonno*, qoftë *sonno*, nuk ka ndryshim përta të përket kohës dhe vendit, nuk e quejmë aspak të randësishme të pozicionohemi. Kemi vendosë ta konsiderojmë *sonno* (gjumë) thjeshtë për faktin se kështu asht marrë nga shumica e komentuesve.

kur... kam pa - Këtu fillon pjesa e dytë e kangës, ku poeti ka derdhë gjithë përkujdesin, meqë rrëfëhet për vendin ku Virgili kalon përjetësinë mes pshërëtime; vendin që ua ka rezervue, së bashku me të, gjithë njerëzit e shquem të antikitetit.

që kishte thye - Zjarr që then (mposh) terrin rreth e rrotull, tue formue një gjymësferë drite. Ky zjarr jo aq i madh asht një sajim i jashtëzakonshëm dantesk: ai përfaqëson dritën e arsyes njerëzore (në këtë pjesë të Limbit qëndrojnë filozofët dhe poetët e lashtë) e cila, edhe se e kufizue dhe jo e plotë, gjithësesi e ngjashme dhe analoge me atë hyjnore, prej të cilës merr shkëlqimin...

24 Jo sa t'mos dalloj - Jo aq larg, sa mos me dallue, aq ma tepër që tash terri asht thye nga ajo dritë.

njerëz t'shquem - Me këta njerëz të lashtësisë, të denjë për nderim, popullohet kjo pjesë e Limbit, veçue prej të tjerëve. Pikërisht në këtë veçanësi ndryshon Limbi i Dantes nga Limbi i traditës katolike. Si për ta ba edhe ma të dukshëm këtë dallim, poeti e mbush me dritë e lavdi atë vend, në të cilin do të ndeshë filozofët dhe poetët ma të shquem.

25 O ti që dije... thellsisht - Virgili admirohej në Mesjetë, qoftë për dituninë *o dijetar me za*, K.I, v.89), qoftë për artin poetik (*stilen e bukur*, po aty, v.87), dy aspekte të jetës së tij krejtësisht të pandashme: të dyja këto përbajnë figurën e poetit dijetar, çka Dante vetë imitoi tue shkruue *Komedinë*, në të cilën u përpoq të dokumentonte gjithë dituninë e kohës.

kaq e fort nderohen - Asht për t'u theksue se, në mënyrë aspak rastësore, kjo fjalë përsëritet shpesh në këto tercinate e fundit: *t'nderuem, nderon, nderohen*, por edhe në raste të tjera ma vonë (v.93, 100, 133). Nderimi në fakt asht çfarë dallon këto shpirtat nga të tjerët; asht ajo çfarë karakterizon qenien e tyne në përgjithësi, në sintoni të plotë me etikën aristoteliane, ku përnderimi, si shpërblim i virtytit dhe atribut i perëndive, asht gjithë çfarë karakterizon njerëzit e mëdhej. Një përnderim i tillë në jetën tokësore gjen jehonë edhe në jetën e përtejme (v.76-78). Asht kjo ide, krejtësisht danteske dhe përtej çdo skeme teologjike, që gjeneron kështjellën e lashtë (*nobil castello*), me zjarrin që e ndricon dhe gjelbërimin e freskët që, si në Fushat Eliziane të Virgilit, mbulon vendin.

prej tjerësh ndahen qartësisht - Dante tashma ndodhet përpara hijeve të këtyne njerëzve të nderuem që, në dallim prej të tjerëve në Limb, për arsyt që thamë ma nalt, nderohen veçmas. Ai asht para poetëve e filozofëve klasikë e latinë. Asht për t'u theksue se në këtë cep nuk dëgjoen pshërëtimea..

26 Për lavde emnat u lakohen - Fama e tyne, që ende ushton në botën e gjallë, për ta asht gjithashtu një privilegj në Përtje. Përveç përshkrimit të vendit, edhe ai i veçuem dhe mirëdallueshëm nga drita dhe struktura arkitektonike imponuese (kështjellë), përsëritja e këtyne foljeve - *dallohen, privilegjuen* - tregon elementin themelor të kësaj skene, që asht veçimi i këtyne shpirtave nga të gjithë limbëtarët e tjerë në veçanti dhe të Ferrit në përgjithësi. Përmes kësaj gjetjeje poetike Dante nderon madhështinë e poetëve dhe filozofëve të antikitetit.

27 N'atë çast do zâne - Ndërsa Dante e Virgili i janë drejtue vendit të ndrictuem, dëgjoet një za që përshëndet Virgilin dhe e fton për t'i ba nderet e meritueve. Shumë mendojnë se flet Homeri, që u prin të tjerëve. Por po aq shumë mendojnë se flasin njëzani katër poetët që do përmenden ma poshtë, të cilët nderojnë Virgilin.

Ta përnderoni këtë të naltë poet - Varg i thjeshtë, por njëkohësisht i madh, përmes të cilit Dante, me gojën e katër poetëve të shquem, nderon Virgilin, tue e ba kështu thuejse një emblemë të asaj bote nderi e virtyti, që përmes poezisë naltësohej.

për pak largue prej nesh - Virgilit i asht dashtë të ikë përkohësisht nga Limbi, për t'iu gjetë ndihmë Dantes në pyllin e errët, simbas kërkesës së Beatrices (K.II, v.52-120).

28 Mandej, kur ... heshtjen krejt e gjet - Mbasi zani ka ftue për t'i ba nderet e duhuna Virgilit, ka pasue një heshtje, tregues i një respekti të naltë nga ana e poetëve të tjerë ndaj të ngjashmit të tyne.

nja katër hije t'mdhā... - Këta katër poetë janë: Homeri, Horaci, Ovidi e Lukani. Përnderimi që i bajnë Virgilit tregon se ç'vend të randësishëm zen ai në kulturën mesjetare dhe ç'ndikim ka ai në letërsinë e saj. Katër poetët janë përfaqësues të zhanreve ma të randësishme të poezisë: epike (Homeri), satirike (Horaci), elegjiake (Ovidi) dhe tragjike (Lukani).

trishtit as shend nuk kishin n'fytirë të vet - Kondita e banorëve të Limbit, as ndëshkimi e as bekimi, ushtrohet edhe mes dijetarëve por, me shumë mundësi, në një tjetër cilësi. Si e thamë edhe ma nalt, mes tyne nuk dëgjoen pshërëti. Modeli as mundim e as bekim u ushtrohet atyne edhe si një qëndrim stoik. "*Mund të kuptohet në dy mënyra, pra pa shpresë por edhe pa mundime;*

Mësuesi i mirë at'herë ka nisë me m'thanë:
«Shiko e ngul sytë mbi atë që shpatë po mban
87 e para vjen si i mbret me hije t'randë: 29
Homeri asht, poetësh si sovran
e fill përmbas satir Horaci i shkron,
90 Ovidi i treti, n'fund asht ai Lukan.³⁰
Dhe pse çdonjë plotsisht e meriton
atë emën që në kor ka qenë shqiptue,
93 tue m'quejtë të tillë, *kjo vetë i pënderon*».³¹
Kështu, atë shkollë kam pa tu' u grumbullue
të mjeshtrit t'madh t'atij të naltë këndim,
96 që shkron shqiponjë, mbi tjerë tue fluturue.³²
Mbasi mes vedi banë pak kuvendim,
nga unë u sollën për me m'përhëndetë,
99 buzqeshte pa ia nda mësuesi im;
e më se nderë më dhanë ata vërtetë,
se m'banë mes tyne vend përzemërsisht:
102 ndër t'ditunisi i gjashti unë jam gjtë.³⁴
Der shkuem tek drita ecëm ngadalisht,
tue folë për çka me heshtë ma e bukur asht,
105 sa ç'ish me ta të flasësh miqësisht.³⁵
Mbërritëm n'rrazë të një kështjelle t'lashtë,
që ish shtatë herë me mure t'naltë rrethuem
108 e mbrojtun nga një vijë me ujë, përjashtë.³⁶

por për mendimin tim shpjegimi ma i drejtë i vargut do të ishte si vijon: i dijsmi vetëpërbahet në të gjitha raste! (Benvenuti, f.119). Kështu, nga ky kandvështrimi i paraqitjes së të mëdhejve të kështjellës së lashtë, nuk e quejmë me vend të përjashtohet as njeni e as tjetri aspekt i interpretimit.

29 që shpatë po mban - Dante nuk përdor imazhet ikonike me të cilat tradicionalisht shfaqet Homeri, si plak, apo si i verbët. Shpata që poeti mban në dorë e paraqet Homerin me madhësi kalorsiake, çka paraqet dallimin me poetët e tjerë dhe epërsinë që ka poezia epike mbi stilet e tjera.

30 Homeri - Randësia e Homerit asht theksue edhe herë të tjera në *Komedi* (Purgatori, XXII, v.101-102). "*Dante nuk i njihje veprat e Homerit në mënyrë të drejtëpërdrejtë, por veprat të përktitve, sepse, si të gjithë mesjetarët, nuk njihje greqishten e vjetër. Megjithatë e konsideron si poetin ma të madh të kohëve*" (Jakomuci, f.51). Dante duhet të ketë lexue në latinisht prej Homerit fragmentet citue nga Ciceroni e Oraci. Gjithashtu njihje lëvdatat që të gjithë poetët latinë drejtue atij.

Horaci - Lindë në Venoza, më 65 pr.K., ka studiuë në Romë dhe Athinë. Së bashku me Virgjilin, poet në oborin e Augustit. Lirik e satirik, por asht vlerësue sidomos me këtë të fundit në Mesjetë. Satira e tij asht e përfshime në dy volume, si *Satira dhe Epistole. Epodet dhe Odat* (katër volume) janë të tjera përmbledhje të tij poetike. Vdiq në viti 8 pr.K.

Ovidi - Lindun në Sulmona, më 43 pr.K. dhe vdiq më 18 m.K.. Si shkoi në Romë për të studiuë, ra në sy menjëherë për lehtësinë e thurjes së vargjeve. Poet elegjik, shkroi *Amores* e, mandej, gjatë mërgimit në afërsi të Detit të Zi, shkroi *Tristia*. Veprat ma të randësishme janë *Fasti*, në të cilën përshkruen zakonet romake, dhe *Metamorfozat* në të cilat përshkruen dyqind e pesëdhjetë shndërrime mitologjike. Benvenuti thotë: "*Dante e ka dërgue Ovidin në Limb, për shkak të talentit dhe poezisë së naltë, jo për moralin e tij*". Asht poeti latin ma i famshëm në Mesjetë, mbas Virgjilit. Mjaft i randësishëm dhe i përmendun nga Dante në *Komedi*. Për të asht pikë referimi kryesor sidomos për mitet. Aq i vlerësue asht Ovidi për të, sa ia lejon vetës ta sfidojë në një betejë të ashpër poetësh: *të heshtë... Ovidi* (K.XXV, v.97).

Lukani - Lindun në Kordova, më 39 p.K., nip i Senekës. Megjithëse i ri, shkroi një poemë epike me temë ramjen e Trojës, një tragjedi, lirika dhe mbi të gjitha poemën *Farsallie*, mbi luftën civile mes Çezarit dhe Pompeut, e vetmja vepër që ka mbërritë në ditët tona. Poetët latinë të përmendun këtu janë ma të lexuemit e të studiuemit në Mesjetë.

31 atë emën... ka qenë shqiptue - Katër poetët e nderojnë Virgjilin tue e quejt *Poet*. Simbas asaj që thotë Virgjili, të gjithë ata, tue qenë poetë e tue nderue në Virgjilin këtë emën, nderojnë vetveten. Nga ana tjetër, i përmasave të tilla asht ai për Danten dhe epokën e tij, sa të quhet kështu nga Homeri, Horaci, Ovidi dhe Lukani.

32 atë shkollë - Shkolla e poezisë së naltë, që ndërthur në gjirin e vet katër stilet, përfaqëse nga katër poetët e përmendun ma nalt, të kryesuem nga Homeri (shih shënimin e v.83). Në këtë shkollë padyshim Dante ka parasysh edhe Virgjilin, si përfaqësues i dejë e poezisë epike. Kjo shkollë poetësh prihet prej Homerit, asht siç do të shohim shkollën e filozofëve të prihet nga Aristoteli. Në këtë termin në zbulohet admirimi i Dantes: *e bukurja shkollë janë poetët e parapëlqyem, që këtu ka gjatë rastin t'i grumbullojë të gjithë, pavarësisht ku e kur kanë jetue. Nga fjalët që përzgjedh për të rrefye këtë ndodhi të jashtëzakonshme, kuptojmë se dridhet nga emocionet i këtij takimi, jo real padyshim, por përjetue thellësisht si i tillë.*

të mjeshtrit të madh - Bahet fjalë për Homerin, si ma i vjetri dhe ma i randësishmi poet i periudhës klasike, përfaqësuesi *par excellence* i poezisë epike, maja e poezisë së këndueme.

t'atij të naltë këndim - Pikërisht bahet fjalë për poezinë epike *t'atij farë mjeshtrit*, pra Homerit. Asht quejtë *këndim*, meqenëse poezia këndohej dhe nuk shkruhej në kohën e Homerit.

33 Mbasi mes vedi banë pak kuvendim - Tue pa reagimin e poetëve në vargun e dytë të kësaj tercie, ka shumë mundësi që Virgjili t'u ketë shpjegue arsven e mungesës së tij e, rrjedhimisht, për qëllimin e rrugëtimit të dishpëllit të vet. Padyshim që ata, si poetë që janë, vlerësojnë tek ky rrugëtim përprjekjen për të thur poezi të naltë.

u sollën për me m'përhëndetë - Gjestin e përhëndetjes nga ana e katër të mëdhejve drejtue Dantes nuk do ta konsideronim aspak një shenjë krenie nga ana e tij, por ma shumë një vetëdije për dhuntinë e naltë që zotnon, të cilës i drejtohet në fillimin e Kangës II, kur bahet gati me i hy një udhëtimi të tillë poetik, çka do ta bajë atë pjesë të *së bukurës shkollë*.

34 ma se nderë më dhanë - Me e pranue mes tyne poetin modern, nxisin dhe admiruesin e tyne, kjo asht një nder edhe ma i madh se përhëndetja e maparshme (v.98).

ndër t'ditunisi i gjashti unë jam gjtë - Me këtë, Dante përfundimisht vendos një urë mes botës antike dhe kohës së tij.

35 tek drita - Pikërisht ai burim drite (v.68), përshkruie si zjarri që çante terrinën në një cep të Limbit.

tue folë... miqësisht - Me sa duket Dante e shëh të arsyeshme me heshtë për temat që mes tyne kanë folë. Do të ishtë një shmangie e panevojshme nga rrjedha e rrefimit. Natyrshëm asht të mendojmë se kanë folë për poezinë, siç lihet të kuptohet në Purgatori XXII (v.104-105).

36 Mbërritëm n'rrazë të një kështjelle - Me anë të kësaj kështjelle të mirëmbrojtun dhe të veçtue Dante ban të prekshme dhe reale gjendjen të veçantë të këtyne shpirtave. Përsa i përket kuptimit alegorik të *kështjellës* dhe të elementeve të tjera rreth saj, ka shumë mospërputhje mes komentuesve

Si t'ishte tokë e thatë, matanë kaluem;
n'shoqni me ta shtatë portash patëm dalë:
111 arritëm n'një lëndinë të gjelbëruem.³⁷
Pamë njerëz që vërenin thellë, ngadalë,
një hije t'randë po dukej t'gjithë se kanë,
114 dhe flitnin rrallë, por shumë të mendshme fjalë.³⁸
Ashtu, siç ishim, u veçuem n'një anë,
në vend të hapët, t'naltë e drite kallë,
117 aty ku mund të shiheshim të tanë.³⁹
Atje, në bërë të gjelbër, krejt përballë
m'u shfaqën shpirtat që kanë ndritë njerzinë,
120 e se i kam pa, më duket si përrallë.⁴⁰
Elektrën pashë dhe shumë me të të rrinjë,
mes t'cilëve Hektörin dhe Enëan,
123 armue Çezarin, sytë i shkrepëtinjë.⁴¹

të hershëm dhe modernë: shtatë rrrathë me mure, portat në secilin mur, vija e ujit që rrethon kështjellën e që kalohet me shumë lehtësi nga poetët. Tri janë hipotezat ma të pranueshme: 1. Kështjella simbolizon gjithë dituninë njerëzore, ose shkencën, shtatë rrethimet me mur dhe shtatë portat janë disiplinat ditunore si gramatika, retorika, dialektika, aritmetika, gjeometria, muzika e astronomia, ose janë katër virtyte morale, si durimi, drejtësia, morali i naltë, vetëpërbajtja, shtu këtyne tre virtyte intelektuale si: inteligjenca, shkenca, ditunia; 2. Kështjella asht simbol i filozofisë, përba nga shtatë rrrathë, si: fizika, metafizika, etika, politika, ekonomia, matematika dhe dialektika (Jakob Alighieri); 3. Kështjella asht simbol i fisnikërisë njerëzore, rrethue nga virtytet morale dhe intelektuale, me anë të të cilave njeriu mund të arrijë në një stad të naltë e të respektueshëm.

vijë me ujë - Gjithashtu ka mospërputhje të interpretimeve përsa i përket *vijës së ujit*. Veçojmë: 1. Pengesë që i del para njeriut, kur kërkun të arrijë njohuninë; 2. Cilësitë morale që personi i kushtuem ditunisë duhet të ketë - morali asht bashkangitje për njerin e ditun; 3. Për Jakopo Alighierin dhe Benvenutin, aludohet për joshjet e jetës mundane që e pengojnë njeriun të arrijë në njohjen e shkencës; 4. Për Bokaçon vija e ujit asht simbol i të mirave materiale dhe pasunitë, të bukura në dukje, por që kalojnë shpejt, si uji; 5. Për Pjetrin e Dantes, përkundrazi asht dashnia për shkencën që na drejton drejt filozofisë. *«Ka edhe mendime të tjera.*

37 Si t'ishte tokë e thatë... - Poetët e kalojnë vijën e ujit pa asnjë vështirësi, sepse nuk janë pre e pengimeve që përmendëm ma nalt.

lëndinë të gjelbëruem - "*Sipas disave, lëndina përfaqëson praktikën, ndërsa vija e ujit teorinë. Por unë mendoj ndryshe. Lëndina e gjelbërt tregon famën e lavdishme të këtyne shpirtave të shquem, a ka tepër që Virgjili në Eneida VI dhe Homeri në Odisesa XVI na i paraqesin personazhet e shquem tue qëndruë në lëndina të gjelbra*" (Benvenuti, f.125). Jo rastësisht, mendojmë, që Parajsa pagane asht fort e ngjashme me këtë qoshe të Limbit Dantesk.

38 Pamë njerëz... të mendshme fjalë - Në brendësi të kësaj kështjelle fisnike e të lashtë shfaqen njerëz të mençun e të dijshtëm. "*Nga katër veti dallohen njerëzit e ditun: kur shikojnë, i ngrenë sytë me ngadalë; maten kur flasim e nuk përgjigjen menjëherë; flasin rrallë si dhe kanë za të plotë e të ambël*" (Buti, f.131). Këto cilësi e bajnë personin të sjellshëm e të besueshëm e, qoftë në antikitet, qoftë në kohën e poetit, ishte e pamendueshme që një i ditun a i mendshëm të mos i kishte.

39 Ashtu... mund të shiheshim të tanë - "*Dante thotë se u veçuem në një vend të ngritun, ku lavdia e tyne aq shumë shkëlqente, sa mund të shiheshin të gjithë, në kuptimin intelektual, që do të thotë se të gjithë njiheshin për shkak të veprave të nalta, e mes tyne nuk kishte asnjë që të mos kishte një titull a një vepër të lavdishme*" (Benvenuti, f.126). AMCH Leonard (f.102) mendon se ky varg asht rindërtim i vargut virgjilian "*dhe u ngjitem mbi një vend ma të ngritun, ku mundim me pa e njohë fytyrat e të gjithëve sa ishin*" (Eneida VI, 754-755). Kur Enea zbret në Averno për të takue të atin, Ankizin, ky e mendë dërgon në një fushë të hapun, ku ai mundet me pa të gjitha brezat e ardhshëm e të lavdishëm, dalë prej tij.

40 shpirtat që kanë ndritë njerzinë - Ja cilët janë shpirtat që banojnë në këtë kështjellë të Limbit; janë shpirtmedhejtë, apo madhështorët, simbas konceptit të Aristotelit, shprehë në *Etika*, që prej Dantes ka qenë studiuë me rrajë dhe, natyrisht zbatue këto kritere në përzgjedhjen e tij: ata që konsiderohen të medhej, ngaqë përmbushën vepra të tilla, praktikuen në mënyrën ma të mrekullueshme virtytet njerëzore e fituen pashmangshëm nder dhe lavdi. Asht e qartë se një kategori e tillë, që mungon në limbin tradicional, bahet këtu simboli i gjithë madhësishtë njerëzore. Do të gjejmë në këtë kështjellë qoftë herojtë e jetës praktike (luftetarë, mbretër të lavdishëm, gra të virtytshme), qoftë të mëdhejtë e jetës meditative (filozofët e poetët), që janë dy aspektet e jetës njerëzore ku shpaleshin madhështia e shpirti. Natyrisht që aspekti i parë (praktik) asht inferior në raport me të dytin, simbas konceptit aristotelian, siç vërehet qartazi edhe këtu; grupi i dytë asht vendosë në një vend ma të naltë të kështjellës nga Dante (v.130). Duhet të rritheksojmë gjithësesi se madhështia e tyne, jeta plot virtyte, nuk përban garanci shpëtimi për ta. Ky vend, në *Komedinë Hyjnore*, asht gjithësesi pjesë e Ferrit...

e se i kam pa, më duket si përrallë - Asht e pabesueshme nga ana e poetit, që në këtë udhëtim të ketë pa njerëz kaq të virtytshëm, për të cilët ka lexue e dëgjuë aq shumë.

41 pashë... - Rendi i emrave në vazhdim nuk asht rastësishtëm. Grupi i parë, që i përket herojtë të të historisë së Romës, në të cilën pashmangshëm ban pjesë edhe Troja (meqenëse themeluesi i saj asht trojan). Grupi i dytë, ai i filozofëve dhe poetëve të medhej, asht i mbledhun rreth Aristotelit, që përfaqëson nivelin ma të naltë të ditunisë njerëzore. Kështu, të dy grupet rrezatojnë virtytet morale e intelektuale, dinjitetin e nderin ma të naltë që njeri arrin përmes forcave të veta, por që gjithësesi nuk mjafton ta çojë atë tek Perëndia (v.35). Për këtë problem, që Dante nuk mund ta zgjidhë kurrsesi pozitivisht (tue qenë se asht në të njajtën kohë poet, pra në favor të çlirimit të tyne dhe, i krishtenë, i detyruem t'i mbajë ata të *burgosun* në Ferr, por pa vuetjtje) do të flitet shpesh në *Komedi*.

Elektra - Sipas mitologjisë, bijë e Atlantit, me të cilën u dashnue Zeusi, nga lidhja me të cilën lindë Dardani, themeluesi i Trojës. Me Elektrën fillon grupi i parë i shpirtave të lavdishëm, përba nga personazhet të historisë dhe mitologjisë, lidhun direkt ajo jo me historinë e Romës. Nga ata që i rrinjë pranë (*të shumë që me të rrinë*), Dante ka zgjedhë Hektorin dhe Enëan, që i konsideron në të njajtën nivel fisnikërie. I pari asht mbrojtësi i Trojës, të cilit i këndon Homeri, i dyti pasuesi dhe themeluesi i Romës, të cilit i këndon Virgjili.

Hektori - Bir i Priamit, mbretit të Trojës. Qe pikë referimi për trojanët në qëndresën përball akcjeve, që mbanin të rrethuem qytetin. U vra në një duel burmor nga Akili.

Enea - Tjetër hero i Luftës së Trojës, protagonist i *Eneidës*. Si iku nga Troja që po digjej, mbas shumë peripecish, zbarkoi në brigjet e Lacios. Këtu iu desh të luftojë kundër vendasve, kryesue nga mbret Latini.

Çezari - Jul Çezari, pasardhës i Eneas përmes Azganit, të parëldinuit.

Kamilën pashë edhe Pantasilëan,
nga krahu tjetër vrejta mbret Latinin,
126 që rrinte me të bijën, Lavinëan.⁴²
Pashë Brutin, atë që ka përzanë Tarkuinin,
Lukrécian, Julian, Márcian dhe Kornilë,
129 vetmue, mënjatë e njoha Saladinin.⁴³
Mandej, kur ngrita sytë edhe një fije,
pashë kreun e atyne që e meritojnë
132 t'jenë n'ma të naltën majë filozofie.⁴⁴
Tek ai të gjithë kanë sytë dhe e pënderojnë:
pashë se Sokrat por se dhe ai Platon,
135 ma pranë se t'tjerët krahu i qëndrojnë;⁴⁵

Asht mes ma të randësishëmve dhe ma gjenialëve ushtarakë që ka pasë ushtria romake. Lindi në Romë, më 103 pr.K. nga një famije fisnike. Udhëhoqi fushatën kundër galëve, tue shty territoret e Perandorisë, deri në kufi me gjermanikët. Për shkak se shkoi përtej asaj që dëshironte Roma, bashkë me lavdinë që gëzoi në popull, mori zemërimin e Senatit. Ky i fundit, pas fushatës, e ftoi të jepte llogari për betejat e panevojshme, më 49 pr.K. Tue mendue se ky ishte një komplot, desh të hynte në Romë me legionet e tij, gj që përbande shkelje ligjore, mbasi në qytet nuk lejoheshin forcat ushtarake, pikërisht për të mënjatue grushtet e shtetit. Senatit, thirrë në ndihmë, nga Britania, Pompeun, që njëkohësisht ishte dhe ish-dhandëri i tij. Për të evitue ndeshjen me të, Çezari detyrohet t'i vijë anash Romës, ndërkohe që ndiqej nga Pompeu. Por përplasja ishte e pashmangshme. U ndeshën disa herë e, një prej betejave, u zhvillue në Durrës. Por beteja përfundimtare u zhvillue ne Ferasalie, më 44 pr.K., ku Çezari doli fitimtar. Mbas kësaj, kthehet triumfues në Romë. Me fitoren e Çezarit, Republika mori një goditje të fortë, sepse që me këtë rast Roma u udhëhoq *me dorë të fortë* dhe jo nga Senati (parlamenti). Për të rimarrë pushtetin e humbun nga kjo goditje, Senati mendon të eliminojë Çezarin dhe ia arrin. Por çfarë nuk arriti ishte se nuk rikuperoi kurr ma fuqinë absolute vendimmarrëse. Bruti (Luc Juni) dhe Çezari (Jul), që gjenden në shoqinë e Elektrës, janë të vetmit romakë të shquem dhe njëkohësisht të përkundërt për sa u përket pikëpamjeve politike: Luc Jun Bruti, si i pari Konsull i Republikës Romake, Jul Çezari si themelues i Perandorisë. Çezari paraqitet nga poeti i armatosun, ashtu si herojtë e Elizeve (Parajsës) virgjiliane, meqenëse asht shque ma shumë si gjeneral (i Republikës).

42 Kamila - Heroinë virgjiliane, ra në betejat zhvillue mes latinëve (vendas), udhëheqë nga Turini, dhe trojanëve (të ardhun), udhëheqë nga Enea. Asht për t'u theksue se Dante e përmend në një tercinë me Latinin, mbreti i Lacios dhe Lavinea, bija e tij, sepse latinët u shkrrin me trojanët (përmes martesës së Eneas dhe Lavineas), çka i dha fillim Romës së ardhshme.

Pantasilea - Mbreteshë e amazoneve, gra legjendare të shqueme në luftë e në gjuh. Luftoi përkrah trojanëve për mbrojtjen e qytetit. U vra nga Akili. Asht përmendë këtu së bashku me trojanët, sepse ishte aleate e tyne, dhe krejt afër Kamilës, sepse të dyja qenë luftëtare dhe vdiqën në betejë.

Latinin... Lavinean - Mbreti i Lacios në kohën kur zbarkoi Enea. Në shenjë miqësie dhe mikpritjeje i dha për grue të bijën, Lavinien. Ma vonë u bashkue me Turnin, mbretin e Rutulit, kundër tij. Në përballjet mes tyne, mposhtet dhe vritet. Mbas kësaj, Enea arrin të bashkojë latinët e trojanët në një popull të vetëm tue vendosë kështu përfundimisht paqen.

43 Brutin, atë... - Historia tradicionale na thotë se Luc Jun Bruti ka qenë frymëzuesi i luftës kundër mbretit të fundit etrusk që sundonte Romën, Tarkunit të Madh, me të cilin shumël periudha e monarkisë për të fillue ajo republikane. Përemni *atë*, me shumë mundësi asht përdorë nga poeti, jo vetëm për ta veçue nga ma të mëdhejtë e historisë së lavdishme të Romës, por gjithashtu për ta dallue nga një tjetër Brut i njoftun, vrasësin e Çezarit, që gjendet në fundin e Ferrit.

Lukrecia... Kornelia - Katër gra që i përkasin epokës republikane të Romës, katër shembuj të dashunisë bashkëshortore dhe të përkushtimit familjar, simbole të fisnikërisë dhe madhësishtë së shpirtit të gree. *Lukrecia*, Grueja e Kolatinit e cila, mbasi pësoi përdhunim nga Sesto Tarkunin, bir i mbretit të fundit etrusk, Tarkuni të Madh, vrau veten nga turpi. Kjo u ba shkak që Luc Jun Bruti të protestojë ndaj moralit të familjes mbretnore, gj që u përkrah edhe nga populli. Nën presionin e revoltave popullore dhe të parisë së qytetit, Tarkuni jep dorëheqjen dhe tërhiqet në pronat e tij si një qytetar i thjeshtë. *Julia*, bijë e Çezarit dhe grue e Pompeut. *Marcia*, grue e Katon Utiçensit. *Kornelia*, grue e mençun dhe e ditun, bijë e komandantit që drejtoi legionet romake kundër kartagenasve, Shqiponit Afrikan, mundësi i Hanibalit.

vetmue... Saladinin - Sulltani *Salah-ad-Din* (1138-1193) arriti të imponojë forcën e tij në Egjipt dhe Mesopotami. Më 2 tetor 1187, u mori të krishtenëve Jeruzalemin, tue u ba kështu simbol i kalorësisë dhe hero. Fama e tij në Mesjetë ishte e padikuteshme. Sjellja prej burri të godshëm (i gatshëm për kompromis, *godit*), sidomos me rastin e kryqëzatës së tretë, asht kthye në legjendë. Ai e vendos atë në Limb si shëmbull unik i njeriut të virtytshëm mes jo të krishtenëve. E shëh të *vetmue* dhe *mënjatë* sepse asht i një qytetnimi tjetër, atij lindor, për ma tepër, musliman.

44 Mandej - Këtu mbaron lista e të mëdhejve që merituen famën përmes veprave madhështore që kanë përmbushë, kryesisht me armëve. Fillon lista e shpirtnave që i përkushtuen jetën e tyne ditunisë, filozofisë e shkencës.

kur ngrita sytë - Ky asht konfirmimi se grupi që Dante bahet gati t'i rëndisë, asht në një vend ma të naltë se tjetri, sepse poeti, për t'i pa ata, ngre kryet paksa.

pashë kreun... - Aristoteli, lindë në Stagira më 384 pr.K.. Ende i ri që dishëpuli i Platonit dhe qëndroi në Akademi deri sa mësuesi i tij vdiq. Nga viti 342 u zhvendos në Pela, si tutor i birit të Filipit II të Maqedonisë, që ma vonë do të njihjesh si Aleksandri i Madh. Kur u kthye në Athinë, themeloi Liceun, ku zhvilloi mësim rregullisht, deri në vdekje, më 322 pr.K.

Mendimi i tij, që asht në bazën e filozofisë perëndimore, ka ardhë deri tek ne me anë të shkrimeve të shumta e në disa fusha studimi. Aristoteli, për Danten dhe mesjetarët, asht filozofi shëmbullor, çka e tregon edhe ky varg. Mendimi i tij ka qenë vendimtar, përcaktues dhe ndikues në kulturën perëndimore, edhe për faktin se veprat e tij u përkryhen në latinisht, tue u ba kështu popullore. Dante njihje shumë vepra të tij, por thellësisht *Etikën*, të cilën e përmend edhe ma ndej në (*Ferri*, K.XI, v.80), mbi të cilën ndërton mendimin e tij filozofik. Për të Aristoteli përfaqëson nivelin ma të naltë të ditunisë. Tue ditë ç'opinioni ka Dante për të, përjashtimi i tij nga Parajsa asht po aq dramatik sa edhe i Virgjilit.

45 Sokrati - Lindë më 470 pr.K., dijetar dhe filozof. Ka jetue gjithmonë në Athinë, i përkushtuem kërkimeve filozofike dhe mësimdhënia. Në moshë të thyeue, u akuzue se me mësimet e tij po edukonte qetë brezin e ri dhe thuhet se u vetëhelmuë më 399 pr.K. Mësimet e tij na kanë ardhë përmes dëshmimeve të nxënësve, kryesisht nga Platoni, ngaqë nuk la vepra të shkrueme.

Platoni - Tjetër filozof, lindë më 428 pr.K.. Qe nxënës i Sokratit dhe, mbas vdekjes së tij, braktisi qytetin. Ka jetue në Megara, pranë Euklidës, në Egjipt, si dhe në Sicili. Vdiq në Athinë, në vitin 347 pr.K.. Prej tij kemi trashëgue shumë vepra të shkrueme me karakter filozofik.

138 Pashë Demokrit, që botën n'rast përfton,
Diogjën e Tháles, si dhe Anaksagorë,
Herakël, Empedokël dhe Zenon; 46
dhe pashë atë mbledhës barnash me shumë vlerë,
Diaskoriden pra; dhe pashë Orfeun,
141 pashë Tul dhe Lin, Senékën plot me nderë; 47
Euklid gjeometrin, si dhe Ptoloméun,
Galénin, Hipokrátin, Avicénën,
144 dhe atë shpjegues të famshëm, Averréun. 48
Nuk mundem me i përmendë të gjithë me emën,
por dhe t'përmbahesh, sa e vështira gjá,
147 se veç me fjalë, nuk mund t'përfshij gjithë temën.
49

Dhe grupi i t'gjashtve duhej tash me u nda:
për tjetër shteg më priu ai urtësi,
150 larg qetësisë, ku ajri ushton pa prã.

Dhe erdhëm në një vend plot errësi.

50

krahut i qëndrojnë - Për shkak të kontributeve të tyre në filozofi, Sokrati dhe Platoni janë mjaft afër Aristotelit, mbajtë të si ma i madhi ndër filozofë.

46 **Demokriti** - Lindë në Abdera më 460 pr.K.. Kontribuo në matematikë, fizikë, etikë. Nga veprat e tij na kanë ardhë vetëm fragmente. Pat intuitën se materia asht e përbame nga grimca të pandashme (atome), dhe shumëllojshmënia e saj asht e përcaktueme nga mënyra e thurjes dhe shthurjes së tyre. Nga ky koncept, arriti në përfundimin se bota është krijue nga rastësia.

Diogjeni - Filozof i shek.IV, vdiq më 323 pr.K. Përbuzte miraditë e jetës, tue vlerësue asketizmin.

Thales - Filozof i shek.VI, vdiq më 546 pr.K., nuk ka lanë trashëgimi të shkrueme, por në traditën e filozofisë së lashtë thuhet se ka hedhë themelet e matematikës dhe gjeometrisë. Një nga teoritë e tij asht se çdo gjë ka lindë nga uji, si elementi jetësor i të gjitha qenieve.

Anaksagorë - Lindë në shek.V pr.K.. Filozof, mësues i tragjedioografit Euripid dhe shtetarit Perikli.

Empedokle - Mjek dhe filozof i shek.V pr.K.. Sipas legjendës, u hodh në kraterin e vullkanit Etna dhe u shndërrue në perëndi. Katër janë për të elementet bazë: uji, dheu, ajri dhe zjarri, të cilat përcaktojnë jetën dhe vdekjen.

Erakliti - Lindë në Efes shek.VI pr.K., që i pari filozof që u mor me studimin e natyrës njerëzore në veprën *Përveth natyrës*. Shpirti i Universit asht zjarri dhe gjithëka i asht nënshtruar një të tilli që përpin. Zjarri i njeriut asht arsyeja, përmes të cilës kuptohet harmonia e Kozmosit...

Zenoni - Nuk dihet me saktësi nëse Dante i referohet Zenonit të Eleas, apo Zenonit të Qipros. I pari ka lindë më 480 pr.K., dhe vdiq në tortura, mbasi u zbulue se kish komplotue ndaj tiranit. Dialektika ishte landa ku ai dha kontribute. I dyti, filozof (336 - 264 pr.K.), vdiq i vetëvrarë. Nga ai kanë mbetë vetëm disa fragmente të veprave.

47 **Diaskoride** - Lindë në shek.I p.K., në Siçili. Fakti që për shumë kohë ishte shoqgues i ushtrisë romake, i dha mundësi të njëjte shumë vende e bimësinë e tyre, sidomos barnat mjekësore. Përpiloi *"De materia medica"*, njëfarë enciklopedie mjekësore-farmaceutike, në të cilën katalogoi barnat me efekte shëruese.

Orfeu - Bir i nimfës Kaliope dhe Apolonit, perëndisë së poezisë. I dashunuem fort mbas gruas së tij Euridika, e cila vdiq rastësisht nga një kafshim gjarpni, zbrer në Averno, në një tentativë të dëshpërue për ta përqafue edhe njëherë gruen e tij të dashun. Me anë të poezisë dhe muzikës arrin të magjepsë dhe përmllojë Hadesin zemërgur, i cili e lejon atë të marrë gruen në botën e të gjallëve. Por, për shkak të një dobësie njerëzore, nuk arrin, vajtimin për të cilën e shpreh përmes poezisë dhe muzikës. Me emnin e tij na kanë ardhë 87 himne dhe poema *Argonautika*.

Tullio - Mark Tulio Ciceroni, lindë në Arpino, më 106 pr.K.. U shkollue si jurist, filozof dhe letrar. Orator i madh i Romës, si edhe politikan; konsull më 63, akuzuesi ma i zjarrtë i Katilinës për komplot. Më 58 u dëbue prej Rome nga çezarianët. I urruem nga Antoni, u vra më 43. Prej tij kanë mbetë *Epistolari*, vepra politike, filozofike dhe 58 oratori.

Lino - Bir i Apolonit, krijues i melodisë, ritmit dhe alfabetit. Vdiq dhunisht për shkak se kishte guxue të sfidonte të atin.

Seneka - Lindë më 5 pr.K., në Kor dovë të Spanjës, por edukue dhe natyralize romak. Më 49 p.K. iu besue edukimi i birit adoptiv të perandorit Klaudio, që ma vonë do të njihet si perandori Neron. I shtymë nga ky i fundit, detyrohet të vetëvritet më 65 p.K., mbasi mendohej se bante pjesë në një komplot kundër tij. E ka shpalosë mendimin filozofik në *Dilogjet* dhe në vepra të tjera. Shkroi gjithashtu edhe nantë tragjedi, që u banë modele të mizorisë së skajshme të pasioneve, viktimitë e të cilave rezultoi të ishte edhe vetë.

48 **Euklidi** - Matematikan, shek.III pr.K., studioi në Athinë dhe në Aleksandri të Egjiptit. Vepra e tij *Elementet* asht në themelin e gjeometrisë së quejtn simbolas emnit të tij, *euklidiane*. Me Euklidin fillon lista e shkencëtarëve, matematikanëve dhe mjekëve.

Ptolomeu - Astronom dhe matematikan grek, shek.II pr.K., lindë në Egjipt, zhvilloi aktivitetin e tij në Aleksandri. E mendoi Universin me qendër Tokën. Shkrimet e tij, përkthye në latinisht, u përhapën në Perëndim në një vëllim me titull *"Almagest"*.

Hipokrati - Lindë në shek.V pr.K., ishte mjeku ma i famshëm i antikitetit, themelues i një shkollë të randësishme mjekësie. Prej tij kemi një seri shkrimesh grumbullue nën titullin *Corpus Hippocraticum*, sidomos betimin e famshëm të mjekut, quejtë *"betimi i Hipokratit"*.

Galeni - Lindë në Pergam, më 129 p.K., vdiq në Romë më 201. Mjek, studioi qarkullimin e gjakut. Asht konsiderue si themeluesi i metodës së eksperimentimit në mjekësi.

Avicena - Mjek dhe filozof, i famshëm në Lindje, por edhe në Perëndim, teoritë e të cilit studioheshin në shkolla. Jetoj rreth vitit 1000 p.K..

Averreu - Lindë më 1126 p.K., ishte filozof, studioi matematikë, astronomi dhe mjekësi. U përpoq të përputhte Kuratin me shkencën, tue u bazue në teoritë e Aristotelit. I famshëm në Mesjetë për këtë tentativë të tijën. Ashtu si Saladini, dy shkencëtarët e fundit i përkasin botës moderne jokristiane, të cilët Dante i respekton. Që të dy janë komentues të Aristotelit, i pari i shek.X dhe i dyti i shek.XII, të cilët patën një ndikim të madh në mendimin filozofik të Mesjetës. Dante i njih dhe i citon komentet e tyre, por respekton në mënyrë të veçantë të dytin, ndaj të cilit ka pasë një polemikë të madhe doktrinale, kryesisht përse i përket interpretimeve të tij mbi Aristotelin dhe mendimeve të tij për Krishtërimin. Shumë teza të Averreut janë dënuar nga Kisha.

49 **Nuk mundem me i përmendë të gjithë** - Lista e të mëdheve përfundon këtu. Për t'i përmendë të gjithë që ka pa, asht e pamundun.

50 **Dhe grupi i t'gjashtve** - Grupi i poetëve formue nga Homeri, Horaci, Ovidi dhe Lukani, që gjenden në Limb, dhe nga Dante e Virgjili, që për aty

Fjalor shpjegues i Këngës IV

NË TEKST

- mundi,-a** IV, v.28 “mundim-i”, formim nga *mund* me prap. -i, neologjizëm i krijuar nga autori.
- ngadalisht** IV, v.103 “*ndajf*. ngadalë; me ngadalë”, formim nga *ngadalë/ë*/ me prap. -isht, neologjizëm, krijuar i ri i autorit.
- qarkosë (me)** IV, v.24 “qarkoj; rrethoj”, formim nga *qark* me prap. -os/ë.
- rretheqark** IV, v.69 “në mënyrë rrethore; rreth e rreth”.

NË SHËNIME

- adoptiv-e** IV, sh.47 “që është përshtatur (si bir, ide, atdhe)”.
- ditunor-e** IV, sh.36 “që ka të bëjë me diturinë”.
- euklidian-e** IV, sh.48 “në mënyrën e Euklidit; sipas Euklidit”.
- gjermanik-e** IV, sh.41 “që i takon Gjermanisë; që është e Gjermanisë”.
- godshëm (i)** IV, sh.43 “i gatshëm për të rënë në godi”, formim nga emri *godi* me prap. -shëm, neologjizëm i autorit.
- limbëtarë-t** IV, sh.3 “vuajtësit e Limbit”.
- meditativ-e** IV, sh.40 “që mediton”.
- mirëdallueshëm (i)** IV, sh.26 “që dallohet mirë”, kompozitë e ndërtuar nga mbiem. *mirë* dhe *dallueshëm*. Kalk gjuhësor i krijuar nga autori.
- natyralizue (me u)** IV, sh.47 “me iu përshtatë mentalitetit (të vendit pritës)”.
- ngjyrëkuqe,-ja** IV, sh.1 “të qenurit me ngjyrë të kuqe; /ai/ që është me ngjyrë të kuqe”, kompozitë e ndërtuar nga *ngjyrë + kuqe*, neologjizëm i autorit.
- palumtuni,-a** IV, sh.3 “të qenurit i palumtur; këtu: të qenurit në Limb”, formim nga emri *lumtuni* me parashtesën *pa-*, neologjizëm i krijuar nga autori.
- pamendueshëm (i)** IV, sh.38 “që nuk merret me mend”; formim nga mbiem. (i) *mendueshëm* me parashtesën *pa-*, neologjizëm i autorit.
- parakristian-e** IV, sh.5 “që i përket kohës para Krishtit”.
- pazhvëshëm** IV, sh.6 “që nuk mund të zhvishet; këtu: e natyrshe; e zakonshme”.
- privue (me)** IV, sh.5 “i ndaloj dikujt diçka; nuk lejoj”.
- ridimensionue (me)** IV, sh.4 “rishikim i dimensioneve; *fig.* ndryshon opinion”, formim me parasht. *ri-* dhe foljes *dimensionue*.
- sakramend,-i** IV, sh.12 “simbol i jashtëm i një gjëje të shejtë, të dukshëm dhe të shuguruar i hirësisë së padukshme; krijuar nga Jezua Krishti, i cili e bën njeriun të dashur të Zotit; shenjat e shenjta të Kishës, që i bashkojnë besimtarët në misterin e Krishtit, shembjesit të njerëzimit; eukaristë; oste e shejtë.”
- tridimensionue (me)** IV, sh.4 “paraqes dishka në tri dimension; *fig.* paraqes në tërësi; këtu: jep pamje reale”.
- veçanësi,-a** IV, sh.8 “veçantë(-a)”.
- vegjetiv-e** IV, sh.1 “që ka të bëjë me jetën biologjike, jo me atë intelektuale a shpirtërore”.
- vendimmarrës-e** IV, sh.41 “që merr vendime”

Fjalor shpjegues i Këngës III

NË TEKST

- hakërrue (me u)** III, v.128 “drejtohem (dikujt) me fjalë të ashpra, kërcënuese”.
- kurrsi** III, v.56 “në asnjë mënyrë”; pranëvënie (juxtapozicion) i *kurr + si*”.
- lé (me)** III, v.105 “lind”.
- mëshirëtrëte** III, v.102 “pa mëshirë; në mënyrë të pamëshirshme; që ka humbë mëshirën”; kompozitë e formuar nga *mëshirë + tretë*; neologjizëm i vetë autorit.
- ndejë (i)** III, v.118 “ujë/ i ndenj; ujë/ që nuk lëviz; /ujë/ i pistë”.
- jetëzezë,-a** - III, v.47 “jeta plot vujtje e të dënuemve në Ferr, që as nuk ndryshon as nuk mbaron kurrë”, kompozitë e formuar nga *jetë + zezë*; krijuar i vetë autorit.
- ngurruem** III, v.111 “që ngurron; që heziton”.
- pakuem (i)** III, v.40 “që është pakuar; që është bërë më i vogël; që është zvogëluar”.
- pamatë (i)** III, v.55 “që nuk mund të matet; këtu: që nuk mund të numërohet”; formim nga folja */me/ matë* me parashtesën *pa-*.
- prã (me)** III, v.125 “pushoj; rresh”.
- përbind** III, v.25 “diçka/ e frikshme; /diçka/ jo e zakonshme; /diçka/ e tmerrshme”, formim nga emri *bind* “/diçka/ që të shtie frikën”, me parashtesën *për-*.
- rî (me)** III, v.105 “lag (me ujë, me lotë etj.); njom”.
- shkurtisht** III, v.45 “shkurtimisht”, formuar nga *shkurt + prapashetësë -isht*, neologjizëm i autorit.
- syulë** III, v.79 “që rri me syulur”, kompozitë e formuar nga *sy + ulë*”; krijuar i vetë autorit.
- varkue (me)** III, v.82 “lundroj me varkë”.
- zjarrmue (me u)** III, v.94 “nxehem; më hypën inati”.

u kalon rruga.

larg qetësisë - Paqja që mbretton në *kështjellën e lashtë*, ku rrinë njerëzit e shquem e fisnikë, asht në kontrast me pjesën tjetër të Limbit, ku shpirtinat psherëtimë, aq sa qielli dridhet (v.27, 150). Rruga i çon poetët në zonën e errët të Limbit, i errët si gjithë Ferri.

- zjarrmue (i)** III, v.109 “i nxehur; i inatosur”.

NË SHËNIME

- antiromak-e** III, sh.19 “që është kundër Romës”.
- apokrif/ë,-a** III, sh.13 “*apokrif-i* lloj libri a shkrimi me përmbajtje fetare, por që nuk pranohet nga Kisha si autentik; shkrim me autorësi të rreme, fals”. Tekste me autorësi të dyshimtë, jo të vërtetë, fals; libra jo të njohur nga Kisha për të shejtë.
- birësi,-a** III, sh.26 “të qenit bir; që rrjedh nga (...)”.
- destinuar (i)** III, sh.19 “i paracaktuar”.
- disatë (i, e)** III, sh.20 “i shumtë, i shpeshtë (trajtimi...)”.
- dorëhequn (i)** III, sh.19 “ai që ka hequr dorë (nga një post)”.
- dyqindëshi** III, sh.19 “periudha nga viti 1200 deri më 1299; përdorim perifrabor *dyqindëshi /italian/ etj.*”
- frikëndjellës,-i** III, sh.26 “/ai/ që ndjell frikë”; kompozitë e formuar nga *frikë + ndjellës*; krijuar i vetë autorit.
- huqë (me)** III, sh.6 “mos me i ra shenjit; me dalë huq”; formuar nga ndajf. *huq*.
- kanonikisht** III, sh.19 “që është në mënyrën kanonike, ligjore”; formuar nga *kanonik* me prap. -isht.
- kundërthanë (me)** III, sh.35 “mohoj çfarë thashë më parë”; kompozitë e ndërtuar nga *kundër + thanë*”.
- lateral/e** III, sh.4 “ad litteram; fjalë për fjalë”.
- mosdakortësi,-a** III, sh.25 “të mosqenit dakord (në një mendje) për një punë etj.”, formim nga *mos + dakordësi*; neologjizëm i krijuar nga vetë autori.
- mosvep/ër,-ra** III, sh.12 “mosveprimi; të qenit indiferent”, kompozitë e formuar nga *mos + vepër*.
- pakalbshëm (i)** III, sh.3 “që nuk është i kalbur; që nuk kalbet”; ndërtuar nga mb. (i) *kalbshëm*, me parashtesën privative *pa-*.
- pangadishullor,-e** III, sh.24 “që i perket gjithë gadishullit (këtu *Ballkanik*, apo *Ilirik*)”.
- papni,-a** III, sh.19 “koha e të qenurit papë”.
- paraferr,-i** III, sh.9 “vendi që ndodhet para se te hyhet në ferr e ku ndëshkohen ata që nuk kanë bërë as mirë, as keq”, kompozitë e formuar nga *para + ferr*; neologjizëm i krijuar nga vetë autori.
- parëbirësi,-a** III, sh.19 “të qenurit fëmija i parë; kompozitë e ndërtuar nga /i/ *parë + birësi* (khs. Buzukun i *parilemë*, lat. *primogenitus*).
- patjetërsueshmëni,-a** III, sh.33 “të qenurit i patjetërsueshëm”, formim me parashtesën *pa-* dhe *tjetërsueshëm*.
- primat,-i** III, sh.19 “përparësi (këtu: e autoritetit kishtar ndaj atij temporal/sekular)”.
 - përlëvduem (i)** III, sh.19 “i lavdëruar në shkallën sipërore”; formuar nga mbiem. (i) *lëvduem* me parashtesën intensive *për-*.
 - përsëdrejti** III, sh.3 “drejtpërdrejt; direkt”; pranëvënie (juxtapozicion) e formuar nga *për së drejti*.
 - përçudshëm (i)** III, sh.26 “që është i përçudur; që të kall tmerr”.
 - përçudshëm** III, sh.26 “*ndajf.* në mënyrë të përçudur; të tmerrshme”.
 - rikonfirmue (me u)** III, sh.23 “konfirmoj përsëri, për së dyti; përmend përsëri vërtetësinë e një fenomeni a gjëje”, formim nga folja *konfirmue* me parashtesën *ri-*.
 - rindezë (me u)** III, sh.19 “me u ndezë përsëri”, formim nga folja *ndezë* me parashtesën *ri-*.
 - ritrajtue (me u)** III, sh.20 “me u trajtue për së dyti”, formim nga folja *trajtue* me parashtesën *ri-*.
 - shakullues-e** III, sh.8 “që është si shakull; që të lë për tokë të shtrirë-si shakull; befatasue, e papritur”.
 - trazues,-i** III, sh.1 “që të trazon; që të trondit”.
 - vetëvendosës-e** III, sh.21 “që vendos vetë; i pavarur; i lirë”, kompozitë e formuar nga *vetë + vendos/ës-*, neologjizëm, krijuar i autorit.
 - virgjilian-e** III, sh.8 “që janë të Virgjilit; që i përkasin Virgjilit”.



(Kanga V vijon në numrin e ardhshëm)

Nga manifestimi "Zëri i Vllazërimit" 2018



REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh **Kimay**
PRODUCTION Produzione Giacche

